



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 38/2019 (JR)
Datë 04.09.2019

Nr. 8 i vendimit
Datë 09.03.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.03.2021, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Tonči Petković, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Idriz Mulkurti, gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 159, datë 14.06.2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 47 dhe 51, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 159, datë 14.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Idriz Mulkurti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua procesit të rivlerësimit me shortin e hedhur nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më datë 15.05.2018. Në funksion të hetimit administrativ, Komisioni administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

1.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se:

- i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) ka kryer deklarim të rremë;
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2. DSIK-ja i dërgoi Komisionit raportin e kontrollit të figurës², bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Idriz Mulkurti (Mulkurtaj).

1.3. KLGj-ja i dërgoi Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit³, për periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016, bazuar në formularin e vetëdeklarimit të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të llojit vendime gjyqësore të viteve 2014, 2015 dhe 2016, 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura me short dhe të dhëna nga burimet arkivore të KLGj-së (ish-KLD-së).

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 03.04.2018.

² Shkresa nr. {***} prot., datë 02.11.2017.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.02.2019.

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Me vendimin nr. 159, datë 14.06.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit u bazua në të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioni konstatoi si vijon:

2.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar është negativ dhe subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikojë me burime të ligjshme shpenzimet e kryera ndër vite. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë Komisionin lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura prej tij:

(i) për pagesën e këstit të parë të blerjes së apartamentit në shumën 20.600 euro (ose 2.548.282 lekë). Subjekti mund të paguante vetëm shumën prej 979.858 lekësh;

(ii) për shumën prej 10.800 eurosh (ose 1.499.148 lekësh) të përdorur për blerjen e garazhit; dhe

(iii) për pagesën e studimeve për të birin në Londër, në shumën 11.222 paund (ose 1.575.905 lekë), kishte një mungesë në shumën prej 1.159.630 lekësh.

2.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

2.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”; ka nivel minimal kualifikues, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, në vlerësim të denoncimeve të ardhura në Komision, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues nuk gjeti indicie apo fakte të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë.

3. Në përfundim, bazuar në nenet 4, pika 2, 58, pika 1, germa “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar në dhënien e masës së shkarkimit nga detyra.

II. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim kundër vendimit të Komisionit⁴, mbështetur në nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”); nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016; nenet 47 dhe 51, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), me objekt ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Në kërkimin përfundimtar të ankimit, subjekti i rivlerësimit, bazuar në

⁴ Regjistruar në Komision më datë 31.07.2019.

nenet 63, pika 1, 65, 66, pika 1, germa “b” dhe 58, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47 dhe 51, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, kërkoi kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes së tij, ndryshimin e vendimit nr. 159, datë 14.06.2019, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

5. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer “disa” shkelje të rënda procedurale dhe materiale, që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 84/2016, për sa i përket procedurës së gjykimit, mënyrës së arsytimit të pretendimeve, analizës së fakteve dhe rrethanave të dala gjatë gjykimit, gjuhës së përdorur në arsyetimin e vendimit dhe logjikës së gabuar në arritjen e përfundimeve, duke cenuar rëndë të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.

6. Lidhur me pretendimet për shkelje procedurale, subjekti i rivlerësimit parashtron në mënyrë të përmbledhur se:

6.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe akteve rregulluese të procesit të rivlerësimit dhe rezultat i një procesi të paragjykuar që në nisje dhe mungesës së analizës të provave të paraqitura gjatë procesit.

6.2. Vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të rëndë të parimit të paanësisë. Të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që kanë kryer hetimin administrativ, kanë dhënë vendimin përfundimtar dhe zgjidhur çështjen në themel. Kjo shkelje cenon parimet e procesit të rregullt ligjor të garantuar nga Kushtetuta, neni 6, pika 1 e KEDNj-së, ligji nr. 84/2016 dhe Kodi i Procedurave Administrative. Në zbatim të nenit 108, germa “a” e Kodit të Procedurave Administrative, Kolegji duhet ta vlerësojë vendimin si absolutisht të pavlefshëm.

7. Lidhur me pretendimet për themelin e gjykimit, subjekti i rivlerësimit parashtron në mënyrë të përmbledhur se:

7.1. Përfundimet e ILDKPKI-së lidhur me pasuritë, blerjen e apartamentit në Tiranë, blerjen e automjetit të markës “Mercedes Benz”, blerje garazhi në Tiranë, deklaratën noteriale për sipërfaqen 1000 m² në fshatin {***} [Durrës] bien ndesh me konkluzionet e të njëjtit institucion në vitet 2012 e 2015, kur subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar dy herë kontrollit nga ILDKPKI-ja për këto pasuri.

7.2. Ka pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë, në vlerën 50.600 euro (6.259.372 lekë), pasi ka pasur mundësi kursimi në shumën 1.368.757 lekë për vitet 2005 – 2006. Pjesa tjetër e vlerës së apartamentit është përballuar me kredinë në vlerën 5.000.000 lekë. Kësti i parë për prenotimin e apartamentit, në shumën 20.600 euro (konvertuar në 2.548.282 lekë), është shlyer më datë 06.09.2006, me huanë në vlerën 1.500.000 lekë, të marrë *cash* te z. R. G. në gusht 2006 dhe kthyer në dhjetor 2006, kur është lëvruar kredia nga Raiffeisen Bank.

7.3. Ka pasur burimet financiare të ligjshme për blerjen e garazhit me sipërfaqe 22,2 m² në Tiranë, në vlerën 14.000 euro, më datë 26.06.2010, pasi ka provuar që kjo pasuri është blerë me kursimet familjare dhe me të ardhurat në shumën 10.800 euro nga qiraja e banesës në Bajram Curri. Akti i dhënies me qira [i datës 30.09.2010] nuk është fiktiv. Qiradhënësi [subjekti i rivlerësimit] është pronar i ligjshëm i banesës, është paguar tatim në burim për qiranë dhe se qiramarrësi ka pasur burime të ligjshme për pagimin e qirasë paradhënie.

7.4. Shpenzimet për blerjen e automjetit [marka “Mercedes Benz”] me vlerë 5.000 euro dhe vlerë zhdoganimi 379.054 lekë në vitin 2010, janë përballuar nga kursimet e viteve 2007 – 2009, të cilat kanë qenë në total 1.074.859 lekë. Për rrjedhojë, deklarimi në *deklaratën vetting* është i saktë. Për këtë çështje, ka dhënë shpjegimet përkatëse në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ.

7.5. Mosdeklarimi në *deklaratën vetting* i pasurisë tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², të ndodhur në Durrës, është i saktë pasi nuk mund të deklaronte një pasuri mbi të cilën nuk ka asnjë të drejtë reale, provuar edhe nga hetimi i kryer nga Komisioni dhe nga përgjigjet e institucioneve, sipas të cilave nëna e subjektit nuk ka pasur tokë në pronësi apo në përdorim në Durrës.

7.6. Në llogaritë bankare të familjarëve të tij (personave të lidhur) nuk ka pasur të ardhura të depozituara veçmas apo gjendje *cash*. Kartat bankare janë përdorur për blerje *online* prej vajzës dhe shoqeve e saj; në këto kushte shpenzimet e kryera janë shpenzime familjare dhe nuk duhet të pasqyrohen si shpenzime të veçuara. Shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për vitin 2018, duhet të zbriten duke mbetur në vlerën 41.120 lekë, pasi një pjesë e tyre janë mbuluar nga dërgesa monetare në emër të vajzës më datë 17.08.2018, nga E. L..

7.7. Shpenzimet e udhëtimeve të tij dhe familjarëve të tij për periudhën 2009 – 2018, në disa raste janë mbuluar nga të tretë. Në rastin e udhëtimeve për në Tropojë, shpenzimet nuk duhet të llogariten më vete pasi janë të përfshira në anketën e buxhetit të familjes brenda limitit për shpenzimet për transport familjar, ndërsa shpenzimet e transportit për në punë janë përballuar nga shteti, si trajtim preferencial.

7.8. Shpenzimet e kryera për shkollimin e të birit në Angli, rrjedhin nga burime të ligjshme financiare. Subjekti ka pasur aftësi të kursejë gjatë viteve 2012 – 2015 shumën prej 1.410.100 lekësh në datën 18.06.2018 në llogarinë e tij bankare, në shumën totale 1.500.000 lekë gjendje *cash* në banesë, deklaruar në *deklaratën vetting*.

7.9. Nuk ka gjendje financiare negative në vlerën totale prej (–) 3.121.085 lekësh. Subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar të gjitha shpenzimet e kryera prej tij dhe familjes, përgjatë periudhës 2006 – 2014, të krijuara nga qiraja e banesës, ndryshimet në shpenzimet për udhëtimet dhe për blerjet *online*.

7.10. Gjetjet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk janë të sakta; edhe sikur të merren të mirëqena, ato bien ndesh me nenin D, pika 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme.

8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ka qenë korrekt në zbatim të qëllimit të ligjit nr. 84/2016, ka pasur një performancë të admirueshme duke zbatuar me rigorozitet legjislaionin në fuqi, ka gjykuar çështje penale të grupeve më të rrezikshme kriminale në Shqipëri, nuk është tërhequr para presioneve dhe ka dhënë drejtësi. Sipas subjektit të rivlerësimit, puna e tij është vlerësuar në vitin 2015, kur ai është konsideruar si një ndër 10 njerëzit më të vlerësuar të atij viti, e provuar nga vendimet për çështjet ku ka qenë kryesues ose anëtar, si dhe nga disa artikuj të shtypit të shkruar ose viziv.
9. Për të provuar shkaqet dhe pretendimet në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor me qëllim rivlerësimin e provave që janë pjesë e dosjeve të administruara nga Komisioni, provat e reja që i ka bashkëlidhur ankimit dhe ato që ai do të paraqesë përpara datës së zhvillimit të seancës gjyqësore për gjykimin e çështjes së tij, si dhe thirrjen e personave të caktuar me cilësinë e dëshmitarëve për të vërtetuar dhe provuar pretendimet e tij.
10. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit 9 (nëntë) akte të cilësuar “prova të reja”, të listuara si më poshtë.
 - i) Shkresë e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, datë 23.07.2019, nëpërmjet së cilës konfirmohet që subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështje penale apo civile me palë R. G., për periudhën [e kërkuar] 01.09.1995 – 01.03.2004.
 - ii) Shkresë e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda [datë 26.07.2019], sipas së cilës nga regjistrat themeltarë për vitet 2004 – 2014, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur çështje/kërkesa në shqyrtim si gjyqtar pranë kësaj gjykate për procedime penale apo pasurore, apo dhënë vendime gjyqësore ndaj shtetasit R. G..
 - iii) Deklaratë e thjeshtë, pa datë, e z. R. G. për të provuar dhënien e huasë në vlerën 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit në vitin 2006, për një afat 6-mujor. Sipas deklaruesit, burimi i kësaj huaje janë dividendët e marrë nga kompania gjatë viteve që ka qenë administrator dhe ortak i vetëm, përkatësisht nga shoqëria “{***}” ShPK dhe nga kompania “{***}”, e përthithur nga shoqëria “{***}” ShPK. Bashkëngjitur deklaratës gjendet një dokument bankar që pasqyron një veprim bankar të kryer pranë bankës Credins, me përshkrimin: “*pag. tatim mbi dividendin e fitimit të vitit 2006 nga {***} ShPK (R.{***})*”, në vlerën 2.300.000 lekë; kopje e deklaratës noteriale të datës 24.05.2019, të z. R. G., sipas së cilës deklaruesi deklaron se në gusht 2006 i ka dhënë hua subjekti të rivlerësimit shumën 1.500.000 lekë, të përdorur prej tij për prenotimin e një apartamenti. Kjo shumë është dhënë pas shpërndarjes së dividendit të kompanisë në vitin 2006, në formën e huasë me afat 6 muaj, dhe i është kthyer shoqërisë në dhjetor 2006; kopje e ekstraktit historik të regjistratit tregtar për të dhënat e subjektit “{***}” ShA dhe të subjektit “{***}” ShPK.

- iv) Deklaratë noteriale e datës 22.07.2019, nga deklaruese E. M.. Deklaruesja jep të dhëna mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera për periudhën 15.12.2010 deri më 15.08.2017.
 - v) Certifikatë nga International Commercial Bank (e njësuar), e datës 18.07.2019, sipas së cilës klienti, E. G.ka depozitë me afat pranë kësaj banke, në shumën 2.805.306,99 lekë.
 - vi) Shkresë nga Union Financiar Tiranë (e njësuar), e datës 19.07.2019, për znj. E. M., sipas së cilës për transfertat e kryera në periudhën e specifikuar nga kërkuesja [01.01.2013 – 31.12.2018] disponohet informacion mbi dy transaksione: tërheqje parash më datë 05.12.2016, me dërgues E. L., nga Franca, në shumën 250 euro dhe më datë 17.08.2018 nga E. L., nga Italia, në shumën 300 euro. Nuk disponohen të dhëna për transaksionet e mëhershme pasi banka mban të dhëna për 5 vite pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare.
 - vii) Vërtetim i datës 25.07.2019 nga Ak – Invest (i njësuar), sipas të cilit prej periudhës janar 2014 e në vazhdim, znj. E. M. nuk ka kryer transaksione monetare nëpërmjet këtij rrjeti. Sipas shkresës, për informacion mbi transaksionet jashtë territorit shqiptar duhet t’i drejtohet MoneyGram International.
 - viii) Shkresë e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda [datë 29.07.2019], sipas së cilës për periudhën 21.02.2004 deri më 21.11.2016, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka punuar pranë kësaj gjykate, transporti nga banesa në gjykatë dhe anasjellas, për të gjithë gjyqtarët, është kryer dhe përballuar financiarisht nga institucioni, me një mbulim mesatar 40 litra karburant në muaj. Gjithashtu, nga ana e gjykatës, është kryer transportimi i subjektit me automjetet e institucionit për çdo veprimtari gjyqësore jashtë gjykatës, si dhe për aktivitetet trajnuese.
 - ix) Shtatë (7) fotografi me pamje të jashtme dhe të brendshme të apartamentit në Bajram Curri.
11. Subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim⁵, në përputhje me afatin 5-ditor para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në Kolegj. Në përfundim të tyre, subjekti i rivlerësimit kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e gjyqtarit. E njëjta kërkesë qëndron edhe në rast se Kolegji do të çmonte të kalonte çështjen për gjykim në seancë gjyqësore publike.
12. Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë 12 akte, në format shkresor dhe CD, të cilësuar prej tij si “prova të reja”, të listuara si më poshtë.
- i) Shkresë e datës 14.01.2021, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që përmban informacion për llojet e veprave penale të gjykuara prej subjektit në periudhën 01.01.2004 – 31.07.2014, pranë kësaj gjykate dhe për masat e dënimit

⁵ Parashtrirat e datës 01.03.2021 janë dërguar në rrugë elektronike dhe me shërbim postar, regjistruar në Kolegj më datë 01.3.2021 dhe 03.03.2021.

të dhëna⁶ prej tij. Bashkëlidhur shkresës gjendet edhe një tabelë përmbledhëse mbi të dhënat e vendimeve, të pandehurve, akuzave dhe masave të dënimit.

- ii) Fotografi dhe artikuj të gazetave për subjektin e rivlerësimit të printuara.
- iii) Deklaratë noteriale e datës 09.01.2020, lëshuar nga z. E. G., me anën e së cilës deklaroi se ka përballuar shpenzimet e udhëtimeve të kryera jashtë shtetit me znj. E. M., në periudhën 2009 – 2014, si dhe të udhëtimeve të vëllait, motrës dhe nënës së saj [persona të lidhur të subjektit të rivlerësimit] në vitin 2014. Deklaruesi po ashtu shprehet se i ka dhuruar motrës së znj. E. M.[znj. E. M.] 1.000 euro në fund të vitit 2010. Të gjitha këto të ardhura kanë qenë përballuar nga biznesi që deklaruesi ushtron prej vitit 2009. Bashkëlidhur kësaj deklarate, gjendet edhe deklarata e mëhershme e z. E. G., e datës 04.09.2019.
- iv) Ekstrakti historik i regjistrit tregtar për subjektin E. G., që specifikon ushtrim veprimtarie bar-kafe. Bashkëlidhur, kopje e njësuar e kontratës së depozitës me afat në International Commercial Bank, datë 02.09.2013, vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, datë 23.05.2019, mbi të dhënat e tatimpaguesit “{***}”.
- v) Deklaratë noteriale, datë 24.09.2019, e deklarueses E. M. që mbështet deklaratën e z. G. të datës 09.01.2019 [shih nënpikën “iii”]. Deklaruesja shprehet se me kursimet e saj ka financuar biletën e avionit për udhëtimin e vëllait Tiranë – Londër, në vlerën 300 euro. Bashkëlidhur, deklarata e mëhershme e znj. E. M., e datës 24.05.2019.
- vi) Raport mbi analizën financiare për periudhën 2003 – 2018 për subjektin e rivlerësimit, të kryer nga eksperti kontabël L. Pj..
- vii) Një fletë e printuar, ku pasqyrohet struktura e buxhetit familjar sipas 12 grupeve kryesore të konsumit për vitet 2007, 2009, 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019, sipas INSTAT-it.
- viii) Shkresë e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda [datë 06.09.2019], sipas së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka proceduar pranë kësaj gjykate çështje/kërkesa në shqyrtim për procedime penale apo pasurore, të ketë dhënë vendime gjyqësore ndaj z. R. G. apo ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.
- ix) Deklaratë noteriale e datës 11.10.2019, me deklarues K. K. e K. K.. Z. K. K. deklaroi se ka përmbushur detyrimet nga kontrata e qirasë e datës 30.09.2010, duke likuiduar paradhënien *cash* për të gjithë shumën sipas kontratës. Po aty, z. K. K. deklaroi se ka qenë në dijeni të marrjes me qira të banesës së subjektit të rivlerësimit në Tropojë nga vëllai i tij. Ky veprim ka pasur për qëllim nevojat e biznesit të shoqërisë “{***}” ShPK. Bashkëlidhur deklaratës gjendet kopje e kontratës noteriale të qirasë [datë 30.09.2010], kopje e shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, datë 25.04.2019, mbi të ardhurat e realizuara nga shoqëria “{***}” ShPK në vitet 2008 dhe 2009, drejtuar Komisionit, dhe pasqyrat financiare për këto dy vite, shkresa e Qendrës Kombëtare të Biznesit e datës 09.04.2019, drejtuar Komisionit, dhe ekstrakti historik i regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë “{***}” ShPK., kopje e shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë e datës 27.02.2019, lidhur me pagesën e

⁶ Sipas shkresës, veprat penale të gjykuara në periudhën në fjalë, përfshijnë ato të parashikuara nga nenet 78, 79, 109, 110, 110/a, 114, 114/b, 128, 230, 236, 283/a, 333/a dhe 334 të Kodit Penal. Masat e dhëna përfshijnë burgim të përjetshëm për 10 të pandehur, 25 – 35 vjet për 15 të pandehur, burgim për 12 - 24 vjet për 125 të pandehur dhe burgim nga 3-10 vjet për 436 të pandehur.

tatimit mbi qiranë në vlerën 148.379,4 lekë, kopje e urdhër derdhjes për tatim taksa kryer pranë Raiffeisen Bank, datë 28.09.2012, dhe bilanci kontabël i shoqërisë {***} ShPK i datës 31.12.2009.

- x) Kopje e shkresës së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, datë 13.05.2014, që përcakton nevojën për të marrë masa mbrojtjeje për subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës për Krime të Rënda.
- xi) Kërkesat e subjektit të rivlerësimit, datë 14.05.2014, datë 05.09.2014 dhe datë 02.03.2015, drejtuar Komisionit të Posaçëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për nevojën e sigurimit të mbrojtjes së veçantë personale.
- xii) CD në të cilën shfaqen pjesë nga dy emisione televizive lidhur me vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit pranë Gjykatës për Krimet e Rënda.

13. Në përmbajtje të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji rivlerësimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit dhe të riparaqitura prej tij, marrjen e provave të reja, bashkëlidhur prapësimeve, dhe nëse ka nevojë çeljen e hetimit gjyqësor dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të disa individëve, e konkretisht:

- i) z. R. G. – lidhur me çështjen e huasë të marrë prej tij në vitin 2006;
- ii) z. K. K. – lidhur me çështjen e marrjes me qira të banesës në Tropojë dhe pagesën e kryer; dhe
- iii) z. E. G.– lidhur me çështjen e mbulimit të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit.

14. Subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrime shtesë me shkrim⁷, ku parashtron analogji mes mungesës së deklaramit të tokës arë [1.000 m²] në fshatin {***}, Durrës, dhe qëndrimin të shumicës së anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit në vendimin nr. 35/2020 (JR), datë 15.12.2020, ku është konstatuar mospasja e detyrimit për deklaramit të subjektit për të deklaruar një pasuri të paluajtshme duke qenë se nuk kishte asnjë të drejtë reale mbi këtë pasuri.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit*

15. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis* në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se është subjekt rivlerësimi dhe ka depozituar ankimin brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të

⁷ Parashtrimet shtesë mbajnë datën 05.03.2021 dhe janë dërguar në rrugë elektronike dhe me shërbim postar më datë 06.03.2021 (regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.03.2021).

vendimit të Komisionit⁸. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh.

16. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”), me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të datës 14.12.2020⁹ dhe vendimeve të dhëna nga 5 (pesë) trupa të ndryshme gjyqësore të Kolegjit, nëpërmjet të cilave u rrëzuan kërkesat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura më datë 22.12.2020 për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e çështjes së tij¹⁰.
17. Fillimisht, trupi gjykues i Kolegjit analizoi kërkesat procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përmbajtje të ankimit dhe të parashtrimeve, që kanë të bëjnë kryesisht me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit, marrjen e provave të reja të paraqitura prej tij dhe thirrjen e dëshmitarëve.

17.1. Në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Në këtë dritë, nga leximi harmonik i parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, trupi gjykues vëren *së pari* se aktet shkresore dhe materialet e paraqitura në CD – të cilësuar “prova të reja”, nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit e që për pasojë të ketë qenë e pamundur paraqitja e tyre në Komision¹¹. *Së dyti*, nuk rezulton që subjekti të ketë ngritur pretendime mbi pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve në cilësinë e provave për shkaqe me natyrë shkeljesh procedurale të kryera nga Komisioni, lidhur me administrimin e provave të paraqitura prej tij. Në këto kushte, çmohet se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë pamundësinë e tij për të paraqitur këto akte apo të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. *Së fundmi*, trupi gjykues i Kolegjit e çmon të panevojshme thirrjen e z. {***}, z. K. dhe z. G. në cilësinë e dëshmitarëve, në kushtet kur nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, të përcjellë në Kolegj, rezultojnë të dhëna dhe informacione të mjaftueshme që hedhin dritë mbi vërtetësinë e pretendimeve të subjektit, e që për pasojë lejojnë vlerësimin tërësor të shkaqeve të ankimit në raport me konkluzionet e evidentuara në vendim. Sidoqoftë, kjo çështje është elaboruar gjerësisht në pjesën arsyetuese të vlerësimit mbi shkaqet e themelit në vijim. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të

⁸ Sipas shënimeve në lajmërimarrjen e shërbimit postar, njoftimi i vendimit të Komisionit nr. {***} prot., datë 15.07.2019, është dorëzuar te subjekti i rivlerësimit më datë 18.07.2019. Ankimi është regjistruar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 31.07.2019.

⁹ Me shortin e datës 14.12.2020, për shkak të pezullimit nga detyra me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 14, datë 24.07.2020, gjyqtari Luan Daci u zëvendësua me gjyqtarin Ardian Hajdari. Shih: <http://kpa.al/njoftim-424/>.

¹⁰ Vendimet nr. 38/6, nr. 38/7, nr. 38/8, nr. 38/9 dhe nr. 38/10 të datës 15.02.2021.

¹¹ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: “[...] Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, pasi nuk plotësohen kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe se gjithashtu konstatohet se gjendemi përpara kushteve të përcaktuara nga neni 49, pika 6, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

17.2. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni nuk ka kryer shkelje procedurale gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, të cilat do të kërkonin korrigjimin e tyre prej Kolegjit, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, e që do të diktonin nevojën e debatit gjyqësor me praninë e palëve dhe për rrjedhojë kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh.

18. Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se parashtrimet shtesë të subjektit të rivlerësimit, megjithëse mbajnë datën 05.03.2021, janë paraqitur më datë 06.03.2021¹², në një afat kohor më pak se 5 ditë përpara zhvillimit të gjykimit – data 09.03.2021¹³. Pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit e lidh paraqitjen e këtij materiali me publikimin e vendimit të Kolegjit nr. 35/2020 (JR), trupi gjykues vlerësoi se në çdo rast jurisprudenca e Kolegjit është e njohur pej tij.

B. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me shkelje procedurale

19. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe akteve normuese të procesit të rivlerësimit, rezultat i një procesi të paragjykuar dhe mungesës së analizës të provave të paraqitura gjatë procesit.* Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk përmend as nuk i merr në analizë provat, nuk u jep fuqi provuese dhe nxjerr rezultate bazuar në “hamendësi” dhe paragjykime, që kanë shoqëruar procesin që në nisje. Komisioni ka marrë vendim bazuar në fakte të pavërteta dhe jo në bazë të provave të paraqitura e disponuara prej tij. Komisioni ka mënjanuar fakte ekzistente dhe lehtësisht të verifikueshme, ka kryer një hetim të cekët, të nxituar dhe paragjykes.

19.1. Nga analiza e akteve në fashikull përkundër pretendimeve të subjektit për provat, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i provave nuk rezulton të jetë pasojë e mosadministrimit apo e mosmarrjes së tyre në konsideratë, por rrjedhojë e vlerës provuese të tyre në raport me kërkesat ligjore. Kjo qasje e Komisionit është në përputhje me ligjin nr. 84/2016, i cili përcakton diskrecionin e Komisionit [dhe Kolegjit] “[...] të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes¹⁴ [...]” dhe që ta bazojnë vendimin e tyre “[...] vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”¹⁵. Ky diskrecion ligjor, në vlerësimin e provave, i gjykatave – e në rastin konkret edhe i një organi administrativ si Komisioni – është në përputhje të plotë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së. Konkretisht, në *García Ruiz kundër Spanjës*, gjykata ka

¹² Shih poshtëshënimin nr. 7.

¹³ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/02/Shpallje-per-seance-DhK-I-Mulkurti.pdf>.

¹⁴ Neni 49, pika 4, fjalia e dytë e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Si më sipër, fjalia e parë e së njëjtës dispozitë.

konkluduar se pranueshmëria dhe vlerësimi i provave mbi themelin në përgjithësi janë kompetencë vetëm e gjykatave kombëtare, të cilat duhet të peshojnë elementet e mbledhura prej tyre dhe se pranueshmëria e provave dhe vlerësimi i tyre në parim janë kompetencë e së drejtës së brendshme dhe gjykatave kombëtare¹⁶. Nën dritën e këtij përcaktimi ligjor, përkundër pretendimeve të subjektit në ankim, të cilat kufizohen në aludimet e përgjithshme sa më sipër, e që në thelb nuk përmbajnë analizë të inkonsistencës mes çfarë është administruar me dokumentacion dhe asaj çfarë është konkluduar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, ky pretendim i subjektit rezulton i pabazuar.

19.2. Po kështu, subjekti i rivlerësimit nuk argumenton motivet që kanë qenë në themel të marrjes së një vendimi të paragjykuar për të nga Komisioni. Nga shqyrtimi i vendimit, rezulton e kundërta. Komisioni në disa raste, në kundërshtim me detyrimet ligjore të cituara edhe në nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka pranuar deklarime të paprovuara me akte dhe dokumente shkresore të subjektit, të cilat janë në favor të qartë të analizës financiare të pretenduar nga vetë subjekti. Të tilla janë, ndër të tjera, shpenzimet e jetesës për vitin 2007, të cilat në analizën financiare të kryer për vitin 2007 janë përlllogaritur *nën nivelin e vlerave zyrtare*¹⁷, të përcjella nga INSTAT-i ILDKPKI-së ndër vite. Ky vlerësim i Komisionit bie ndesh me mënyrën e vlerësimit të këtij zëri shpenzimesh zbatuar nga vetë Komisioni dhe Kolegji tanimë në jurisprudencën e tij. Po ashtu, Komisioni rezulton të ketë pranuar pa asnjë dokumentacion mbështetës pretendimet deklarative të subjektit për mbulimin e shpenzimeve të dasmës së vajzës [E. M.] nga të ftuarit. Së fundmi, Komisioni ka apo ka pranuar zbritjen e një pjese të shpenzimeve të blerjeve *online* të kryera nga personi i lidhur [vajza/E. M.] mbi baza krejtësisht deklarative dhe zbritjen e tyre nga shpenzimet e jetesës të familjes. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pambështetura në ligj dhe në provat e administruara nga Komisioni. Në këtë arsyetim gjejnë shtjellim të zgjeruar pretendimet mbi analizën e provave përgjatë shqyrtimit të tyre në themel.

- 20.** *Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të rëndë të parimit të paanësisë, pasi të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që kanë kryer hetimin administrativ, kanë dhënë vendimin përfundimtar dhe zgjidhur çështjen në themel. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 108, germa “a” e Kodit të Procedurave Administrative, Kolegji duhet ta vlerësojë vendimin si absolutisht të pavlefshëm. Ky fakt, sipas subjektit të rivlerësimit, përbën shkelje flagrante të parimit të paanësisë të garantuar nga Kushtetuta, ligji nr. 84/2016 dhe Kodi i Procedurave Administrative, dhe bie ndesh me parashikimet e nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, si dhe me praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) në çështjen Volkov kundër Ukrainës, Werner kundër Polonisë, Oberschlick kundër Austrisë.*

¹⁶ Shih udhëzuesin mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) - https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQL.pdf [GC], § 28).

¹⁷ Konkretisht, ndërsa shpenzimet e jetesës për vitin 2007, sipas shkresës së ILDKPKI-së përcjellë Komisionit me nr. {***} prot., datë 21.02.2019, për një familje me pesë (5) anëtarë janë 1.179.840 lekë, Komisioni ka zgjedhur të përdorë vlerën e vitit 2008, në shumën 683.100 lekë, duke zëvendësuar vlerësimin e një institucioni zyrtar të specializuar me një vlerësim të vetë Komisionit, i cili nuk rezulton i bazuar në të dhëna zyrtare të asnjë lloji.

Sipas subjektit, jurisprudenca në fjalë ka gjetur cenim të parimit të paanësisë së gjykatës kur të njëjtët zyrtarë zhvillojnë procedurën hetimore dhe atë të dhënies së vendimit përfundimtar. Subjekti i rivlerësimit *sugjeron* që Kolegji të nxjerrë një vendim orientues për Komisionin, që në të ardhmen trupi gjykues që realizon hetimin administrativ të jetë i ndryshëm nga ai që gjykon çështjen dhe merr vendimin përfundimtar, pasi në të kundërt vendimmarrja do të konstatohet absolutisht e pavlefshme për shkak të cenimit të paanësisë së trupit gjykues, e për pasojë, parimit të procesit të rregullt ligjor.

20.1. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se, në zbatim të parimeve mbi të cilat bazohet procesi i rivlerësimit – përfshirë barazinë përpara ligjit, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe parime të tjera që shoqërojnë një proces të rregullt ligjor – ligjvënësi ka përcaktuar Kolegjin si të vetmen gjykatë të procesit që ka tagrat të kontrollojë dhe korrigjojë gabimet procedurale të konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision. Në qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017¹⁸ dhe në opinionin e Komisionit të Venecias¹⁹, organet e procesit të rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor. Pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor për shkak se të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që bëjnë hetimin administrativ, nuk mund të jenë të njëjtë me ata që bëjnë gjykimin dhe marrin vendimin përfundimtar, është i pabazuar. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera në *Morel kundër Francës, Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimin në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar²⁰. GjEDNj-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj *kundër* Shqipërisë, ndër të tjera është shprehur se (paragrafët 307 dhe 308):

307. [...] Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme, është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (shih, për shembull, Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, paragrafi 50, Seria Nr. 154, dhe Morel kundër Francës, nr. 34130/96, paragrafi 45, Gjykata 2000-VI).

308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të

¹⁸ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php - paragrafët 38, 66 dhe 67 të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

²⁰ Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) - https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SOI.pdf.

kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

20.2. Po kështu, referuar edhe vendimeve të GjEDNj-së të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim, cenimi i parimit të paanësisë në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor, për shkak të mënyrës së funksionimit të Komisionit, është i pabazuar. Nga ana tjetër, “sugjerimi” i subjektit të rivlerësimit që Kolegji të nxjerrë një vendim orientues për Komisionin në mënyrë që hetimi administrativ dhe gjykimi të kryhen nga trupa të tjerë gjykues, është i pavend pasi pretendon që Kolegji të orientojë Komisionin në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin vetëm për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme. Mënyra e funksionimit të këtij institucioni të pavarur kushtetues është e përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Këto dy burime të së drejtës përcaktojnë në detaj mënyrën e funksionimit të Komisionit [dhe Kolegjit], si dhe parimet mbi të cilat kryhet hetimi administrativ dhe vendimmarrja. Nga leximi harmonik i dispozitave të Aneksit të Kushtetutës – nenet C, Ç dhe Ë – dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, i cili rregullon detyrat e Komisionit në drejtim të hetimit dhe të zhvillimit të procesit administrativ, në mënyrë të shprehur në të paktën 10 nene²¹, nuk rezulton që legjislatori të ketë përcaktuar në mënyrë të shprehur, apo të ketë heshtur, e për pasojë të ekzistojë nevoja për interpretimin që fazat e ndryshme të rivlerësimit në Komision duhet të drejtohen nga trupa të ndryshëm. Së fundmi, përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias²², ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese²³ dhe, së fundmi, është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNj-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë²⁴. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar tashmë filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

21. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimet e ILDKPKI-së lidhur me pasuritë bien ndesh me konkluzionet e të njëjtit institucion në vitet 2012 e 2015, kur subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar dy herë kontrollit nga ILDKPKI-ja për këto pasuri.*

21.1. Nga shqyrtimi i raportit të ILDKPKI-së, të përcjellë në Komision më datë 03.04.2018, konstatohet se në përfundim të kontrollit për subjektin e rivlerësimit, ka rezultuar: i) deklarim i

²¹ Konkretisht, nenet 14, 45, 49, 50, 52, 53, 55, 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 84/2016.

²² [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

²³ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017 - http://www.gjk.gov.al/ëeb/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

²⁴ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabvie%22:%7B%22document%22:%7B%22itemid%22:%7B%22001-208053%22%7D%7D%7D>.

rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit në Tiranë [me detajet përkatëse], në vitin 2006, pasi kredia e deklaruar si burim është disbursuar pas datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes; ii) deklarim i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e garazhit [me detajet përkatëse] në Tiranë, në vitin 2010, pasi garazhi është blerë në datën 26.06.2010, kurse kontrata e qirasë për përfitimin e vlerës 10.800 euro mban datën 30.09.2010; iii) e dyshimtë vlere e qiradhënies 300 euro/muaj për apartamentin në Bajram Curri, pretendimi se është parapaguar vlere totale 10.800 euro (për 3 vjet), si dhe mënyra e marrjes së kësaj vlere në rrugë jobankare; iv) mungesë dokumentacioni ligjor për sa i përket mënyrës së përfitimit të pasurive tokë-arë me sipërfaqe 2063 m², 4400 m² dhe 6828 m² në {***} Tropojë, të përfituara më pas me kontratë pjesëtimi dhe dhurimi; v) fshehje në deklaratën e pasurisë *vetting* të tokës arë me sipërfaqe 1000 m², në fshatin {***}, sipas deklaratës noteriale nr. {***}, datë 14.10.2013, e cila është deklaruar në deklaratën e interesave private për vitin 2013.

21.2. Trupi gjykues vëren se pretendimi që ngre subjekti i rivlerësimit lidhet me veprimtarinë e ILDKPKI-së ndër vite, bazuar në ligjin nr. 9049/2003. Kontrolli i veprimtarisë së këtij institucioni të pavarur është përtej tagrave të organeve të rivlerësimit. Pesha që zënë raportet e institucioneve të pavarura në procesin e rivlerësimit është trajtuar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, por edhe në Opinionin e Komisionit të Venecias, ku është theksuar se: *[...] Kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të. [...] Vetëm duke garantuar që organet e rivlerësimit do të kenë kontrollin e plotë të këtij procesi [...] Gjykata vlerëson se do të garantohet respektimi i parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe do të parandalohet ushtrimi i kompetencave ligjore në mënyrë të pakontrolluar nga ana e organeve ekzistuese [...]*²⁵.

21.3. Në dritën e sa më sipër, nga shqyrtimi i vendimit, rezulton se përpos konkluzioneve të ILDKPKI-së, Komisioni ka kryer hetim administrativ, ka mbledhur prova dhe fakte e në përfundim i ka vlerësuar ato në raport me kërkesat e legjislacionit të posaçëm për rivlerësimin kalimtar, duke nxjerrë rezultatet dhe konkluzionet për secilën çështje. Konkretisht, nga aktet në fashikull, rezulton që mes subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të jetë zhvilluar një proces komunikimi aktiv në formën e pyetësorëve dhe administrimit e përgjigjeve, shpjegimeve dhe provave të paraqitura. Po ashtu, Komisioni ka zhvilluar hetim dhe ka mbledhur dokumentacion nga institucionet publike dhe private – banka të nivelit të dytë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, tatime, njësi të pushtetit vendor dhe qendror, institucionet që ofrojnë shërbimet utilitare etj. – në funksion të hetimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i

²⁵ Paragrafi 44 i vendimit nr. 2/2017 në: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php – dhe në paragrafin 62 të Opinionit të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

pambështur në ligj dhe në fakte që rrjedhin nga shqyrtimi i hapave të ndjekur në funksion të vendimmarrjes nga Komisioni.

22. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur aftësi paguese për blerjen e pasurisë **apartament banimi me sipërfaqe 84 m², me adresë rr. “{***}”, njësia nr. {***}, Tiranë, të porositur sipas kontratës së porosisë të datës 06.09.2006, në vlerën 50.600 euro (6.259.372 lekë). Blerja përputhet me aftësinë reale të kursimit për vitet 2005 - 2006. Sipas subjektit të rivlerësimit, deklarimi i pasurisë ka qenë vjetor, shpjegimet e tij kanë qenë korrekte dhe likuidimi i pasurisë është bërë brenda vitit me kursimet familjare dhe me kredinë e marrë për këtë qëllim; në përgjigje të pyetjeve të Komisionit ka dhënë shpjegimin se likuidimi është kryer kundrejt mandatpagesave në arkën e shoqërisë sipërmarrëse dhe jo nëpërmjet bankës. Nga Komisioni nuk i është kërkuar të shpjegojë në mënyrë të posaçme prejardhjen e fondeve që janë përdorur për likuidimin e kështit të parë, për të cilën ka dhënë shpjegimet përkatëse në konkluzionet përfundimtare; huaja në vlerën 1.500.000 lekë është marrë dhe dorëzuar *cash* nga z. R. G., dhe e konfirmuar nga deklarata noteriale e këtij të fundit; Komisioni pa të drejtë e ka konsideruar deklaratën të njëanshme dhe nuk e ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ta thirrur në cilësinë e dëshmitarit z. G. Komisioni vë në dyshim burimin e ligjshmërisë së kësaj huaje, ndërkohë që dihet botërisht se z. G. në atë periudhë ka qenë në 10-shen e sipërmarrësve më të pasur në Shqipëri. Subjekti i rivlerësimit argumenton se: a) pasurinë e ka blerë me kredi 5.000.000 lekë të marrë nga Raiffeisen Bank dhe me kursimet familjare të viteve 2005 e 2006, që kanë qenë në total 1.368.757 lekë, nga të cilat 1.254.079 lekë janë shpenzuar për blerjen e apartamentit. Konkretisht, për vitin 2005 të ardhurat familjare kanë qenë 1.210.248 lekë, shpenzimet e jetesës kanë qenë 547.785 lekë dhe aftësia reale për kursim ka qenë 662.463 lekë. Për vitin 2006, të ardhurat familjare kanë qenë 1.254.079 lekë, shpenzimet e jetesës 547.785 lekë dhe aftësia reale për kursim 706.294 lekë; b) kësti i parë më datë 06.09.2006, në shumën 20.600 euro (konvertuar në 2.548.282 lekë), është shlyer me huanë prej 1.500.000 lekësh *cash* nga z. R. G. në gusht 2006, të kthyer në dhjetor 2006, kur është marrë kredia nga Raiffeisen Bank. Në parashtrimet e datës 01.03.2021, subjekti i rivlerësimit pasqyron pjesë nga vendimi i Kolegjit nr. 31/2020 (JR) [që lidhet me subjektin e rivlerësimit E.G.]. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji, pasi të çelë hetimin gjyqësor, të administrojë provat që janë pjesë e dosjeve dhe ato që ka paraqitur në Kolegj, si dhe të thirret me cilësinë e dëshmitarit z. R. G., me qëllim që të provojë sa më sipër.***

22.1. Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar deklarin të rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen pasi kredia që është deklaruar të ketë shërbyer si burim, është disbursuar pas datës së lidhjes së kontratës së sipërmarrjes. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës gjatë hetimit administrativ, pasi konstatoi: (i) mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej 1.568.424 lekësh për pagesën e kështit të parë prej 20.600 eurosh (konvertuar në 2.548.282 lekë) në datën 06.09.2006; dhe (ii) mospërputhje lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie mes deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe deklarimin periodik vjetor, krahasuar me dokumentacionin e administruar në dosje. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se

shpjegimet e subjektit nuk ishin bindëse lidhur me aftësinë paguese të tij për këstin e parë në shumën 20.600 euro për blerjen e apartamentit dhe nuk u provua e kundërta e rezultateve të hetimit.

22.2. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

- i) Me kontratën e sipërmarrjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 06.09.2006, shoqëria ndërtuese “{***}”, në cilësinë e sipërmarrësit, ka marrë përsipër të ndërtojë për llogari të porositësit Idriz Mulkurti, një apartament banimi me sipërfaqe 92 m², me vlerë të plotë 50.600 euro. Sipas kontratës, pagesa do të kryhej në katër (4) këste: i) 40% e vlerës do të paguhej në momentin e lidhjes së kontratës; ii) 30% e vlerës do të paguhej 6 muaj pas datës së lidhjes së kontratës; iii) 20% e vlerës do të paguhej 11 muaj pas datës së lidhjes së kontratës; dhe iv) 10% e vlerës do të paguhej në momentin kur të përfundonin të gjitha punimet, me marrjen e çelësave në dorë. Kontrata përcaktonte se pagesa e këstit të parë do të bëhej me mandatarkëtimi të firmosur dhe vulosur nga pala investitore (sipërmarrësi), shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes të firmosur nga palët në prani të noterit, ndërsa pagesat e tjera do të kryheshin kundrejt mandatarkëtitimit të lëshuar nga sipërmarrësi (neni 6).
- ii) Më datë 26.06.2010, me kontratën e shitblerjes të pasurisë së paluajtshme [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK apartamentin me sipërfaqe 84 m², në vlerën 50.600 euro. Sipas kontratës, vlera e çmimit është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale dhe shitësi deklaron se i ka marrë në dorëzim të hollat.
- iii) Më datë 18.10.2006, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kredimarrësit, ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare dhe hipoteke (për blerje shtëpie banimi ose rikonstruksion) me Raiffeisen Bank, për dhënie e kredisë në shumën deri në 5.000.000 lekë, shumë kjo e disbursuar më datë 04.12.2006.
- iv) Shoqëria “{***}” ShPK, në korrespondencën me Komisionin²⁶, ka bashkëlidhur fotokopjen e kontratave të sipërmarrjes dhe të shitjes së apartamentit dhe fotokopje të mandatarkëtimeve (nr. {***}, datë 06.09.2006, nr. {***}, datë 04.12.2006), dhe ka konfirmuar se pagesa e kryer në total ka qenë 50.600 euro, e kryer në dy këste: më datë 06.09.2006 në vlerën 20.600 euro dhe më datë 04.12.2006 në vlerën 3.700.000 lekë (konvertuar në 30.000 euro).
- v) Në përgjigje të pyetësorit të datës 25.03.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se likuidimin e ka kryer brenda vitit 2006, me kursimet familjare dhe me kredinë e marrë për këtë qëllim. Pagesat janë kryer në arkën e sipërmarrësit kundrejt mandatarkëtitimit. Subjekti ka konfirmuar pagesat sa më sipër të detajuara nga shoqëria “{***}” ShPK, se pagesa e parë është kryer në momentin e prenotimit [më datë 06.09.2006] në shumën 20.600 euro dhe pagesa e dytë [më datë 04.12.2006] në shumën 30.000 euro me tërheqjen e kredisë.
- vi) Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, të dërguara më datë 09.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është blerë për 6.259.372 lekë, nga të cilat 5.000.000 lekë kredi nga Raiffeisen Bank dhe pjesa tjetër, me kursimet e viteve 2005 e 2006 që ishin në vlerën 1.368.757 lekë. Sipas subjektit, pagesa e këstit të parë prej 20.600 eurosh

²⁶ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.03.2019.

[2.548.282 lekë], kryer më 06.09.2006, është mbuluar nëpërmjet huasë prej 1.500.000 lekësh të marrë *cash*, pa interes, nga z. R. G., të cilën e ka kthyer në dhjetor të vitit 2006, kur ka tërhequr kredinë.

vii) Në *deklaratat* e interesave privatë për vitin 2003 dhe për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime, gjendje *cash* apo likuiditete në bankë. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2005, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë prej 500.000 lekësh. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, subjekti ka deklaruar prenotimin e këtij apartamenti në rubrikën përkatëse, duke specifikuar vlerën prej 50.600 eurosh me burim 5 (pesë) milionë lekë nga kredia sipas VKM-së nga Raiffeisen Bank, ndërsa pjesa tjetër nga pakësimi i gjendjes *cash* 500.000 dhe kursime nga paga vjetore, po ashtu në vlerën 500.000 lekë. Kredia për strehim është deklaruar edhe në rubrikën e detyrimeve.

viii) Në *deklaratën vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *apartamentin e banimit* [me detajet përkatëse], blerë në vitin 2006 sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 06.09.2006, dhe asaj të shitjes me kontratën e datës 26.06.2010, me vlerë 50.600 euro. Po aty, subjekti ka deklaruar se fondet e përdorura kanë qenë nga kursimet *cash* dhe nga 5.000.000 lekë kredi, sipas *kontratës së kredisë*, datë 18.10.2006, me Raiffeisen Bank.

22.3. Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë marrjen e huasë nga z. R. G. [në vlerën 1.500.000 lekë] vetëm në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ. Siç është shtjelluar në pikat (vii) dhe (viii), kjo hua nuk është deklaruar në deklaratat e interesave privatë në vitin 2006 dhe as në deklaratën *vetting*, si burim për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me përcaktimet e ligjit për deklarimin e burimit në momentin e krijimit të pasurisë. Në kushtet e deklarimit të një burimi financiar të krijimit të një pasurie për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në Komision (në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ), por edhe aktet e bashkëlidhura ankimit, si dhe kërkesa e tij për të pyetur si dëshmitar z. R. G., nuk ka vlerë provuese për procesin, duket se është një përpjekje për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, konstatuar gjatë hetimit administrativ. Përpos kësaj, subjekti i rivlerësimit – megjithëse ka pasur cilësinë e subjektit deklarues që në vitin 2003 sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe në kundërshtim me detyrimet e tij në kuadër të procesit të rivlerësimit – e deklaron këtë hua 13 vite pas marrjes së saj, në mungesë të provave të kohës në të cilën është dhënë kjo shumë. Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit mbi vlerën provuese të deklarave të interesave privatë ndër vite²⁷, në kushtet kur huaja e pretenduar e përfituar nuk është deklaruar asnjëherë, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni me të drejtë nuk e ka përfshirë këtë hua si burim krijimi të pasurisë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit.

22.4. Argumenti i subjektit të rivlerësimit se deri në momentin kur ai u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk i ka kërkuar të shpjegojë në mënyrë të posaçme prejardhjen

²⁷ *Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019, nr. 5/2020, nr. 27/2020.*

e fondeve që shërbyen për likuidimin e këstit të parë, është i pakuptimtë dhe bie haptazi ndesh me çfarë vetë ka deklaruar. Konkretisht, në deklaratën *vetting*, sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit u është referuar kursimeve *cash* dhe *kredisë*. Më pas, në pyetësorin e datës 25.03.2019, kur i është kërkuar nga Komisioni të provojë/dokumentojë të detajuar mënyrën e pagesës për blerjen e shtëpisë dhe nëse transaksioni është kryer nëpërmjet bankës (pyetja nr. 1), subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar mënyrën e likuidimit në dy këste (shtjelluar edhe në paragrafin 22.2.v) dhe burimin²⁸, pa iu referuar huasë së marrë nga z. G. Së fundmi, edhe referuar dy procesverbaleve të ILDKPKI-së, të viteve 2012 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka bashkëlidhur akte lidhur me blerjen e apartamentit në Tiranë. Në asnjë prej tyre nuk ka përmendur hua nga z. G. apo paraqitur akte provuese për të dokumentuar pagesën e pretenduar pas rezultateve të hetimit dhe në ankim.

22.5. Në përmbledhje të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, se pagesa e këstit të parë është kryer me fondet nga huaja e përfutur, mbeti në nivel deklarativ. Deklarata noteriale e sjellë gjatë procesit të rivlerësimit ka vlerë të kufizuar provuese për shkak të kohës kur është përpiluar dhe çfarë pretendohet aty, nuk konfirmohet me asnjë dokument të kohës kur është dhënë. Si rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se aktet bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve të datës 01.03.2021, të listuara në paragrafin 10, pikat i) – iii) dhe paragrafin 12, pika viii), nuk kanë vlerë provuese për këtë çështje. Së fundmi, konkluzioni i Komisionit qëndron, ndërsa pretendimi i subjektit bie ndesh me faktet dhe është jobindës në kuadër edhe të detyrimeve të tij ligjore ndër vite sipas ligjit nr. 9049/2003 apo ato që rrjedhin për shkak të procesit të rivlerësimit.

22.6. Më tej, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi aftësinë reale për kursim nga të ardhurat familjare për vitet 2005 dhe 2006 – përkatësisht 662.463 lekë dhe 706.294 lekë – të cilat kanë shërbyer si burim për shlyerjen e çmimit të apartamentit (shih paragrafin 22 më sipër), bie ndesh me vlerat e deklaruara prej tij në këto deklarata (shih paragrafin 22.2, pika vii). Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën prej 1.481.541 lekësh për të kryer pagesën e këstit të parë prej 20.600 eurosh (konvertuar në 2.548.282 lekë) në datën 06.09.2006²⁹. Nga ana tjetër, koncepti i aftësisë reale për të kursyer – potencuar si argument në ankim nga subjekti – nuk qëndron logjikisht në dritën e parimeve mbi të cilat mbështetet deklarimi i pasurive dhe vlerësimi i

²⁸ Subjekti është shprehur tekstualisht: “[...] Pra, likuidimin për banesën e kam kryer tërësisht brenda vitit, me kursimet familjare dhe kredinë e marrë për këtë qëllim. Unë për çdo derdhje jam pajisur me mandatarkëtimin, të cilat nuk i kam ruajtur pasi jam pajisur me certifikatën e pronësisë për banesën, por po ju dërgoj fotokopje të mandatarkëtimeve, të cilat i kam tërhequr pranë shoqërisë “{***}” ShPK [...]”.

²⁹ Në këtë analizë janë përllogaritur (i) të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për periudhën 01.01.2006 - 06.09.2006 (data e pagesës së këstit) sipas dokumentacionit; (ii) shpenzimet e jetesës sipas publikimeve të INSTAT-it dhe përdorur nga ILDKPKI-ja për një familje me 5 persona për 8 muaj; (iii) pakësimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë të subjektit dhe personave të lidhur në periudhën mes 31.12.2005-- 06.09.2006, dhe (iv) pakësimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në banesë sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat e interesave privatë. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se nuk është marrë në konsideratë pakësimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë.

burimeve të ligjshme për krijimin e tyre për funksionarët publikë. Konkretisht, aftësia për kursim përfaqëson një vlerë teorike, që rezulton nga zbritja mes të ardhurave dhe shpenzimeve në një vit apo periudhë kohore të caktuar. Kjo vlerë krahasohet me deklarin/deklarimet e subjekteve periodike vjetore [apo *vetting*] për kursime të krijuara, qoftë në sistemin bankar apo jashtë tij, në funksion të kontrollit të pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij në funksion të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa i përket deklarinimit të pasurive.

22.7. Si rrjedhojë, nëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 500.000 lekë në deklaratën periodike për vitin 2005, kjo nënkupton që në momentin e inventarizimit të likuiditeteve më 31 dhjetor, para deklarinimit periodik, kjo sasi parash përfaqëson një vlerë të identifikuar nga subjekti si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, deklaruar në funksion të detyrimeve nga ligji nr. 9049/2003³⁰. Me fjalë të tjera, shuma e kursimeve të vitit përkatës, të deklaruara nga subjekti atë vit, duhet të përbëjë vlerën që *sipas tij realisht* është kursyer atë vit. Diferenca midis të ardhurave të subjektit dhe personave të lidhur dhe shpenzimeve mesatare të publikuara nga statistikat e INSTAT-it për atë vit, që në rastin konkret rezulton në vlerën 662.463 lekë, përbën një përlllogaritje mbi baza *teorike*, përdorur nga ILDKPKI-ja dhe institucionet e rivlerësimit si mbështetje për të përcaktuar pragun përtej të cilit përlllogariten shpenzimet e tjera – përpos atyre bazike të jetesës – dhe pasuritë e krijuara në funksion të analizës së burimeve të ligjshme. Si rrjedhojë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit për vitin 2005 ka deklaruar 500.000 lekë kursime *cash*, jashtë sistemit bankar, është alogjike të pretendohet që në fakt kursimet e tij nuk kanë qenë ato të deklaruara, por ato që rezultojnë si mundësi teorike, si rrjedhojë e vrojtimeve statistikore të INSTAT-it me familje nga gjithë grupimet demografike të mundshme, që për nga natyra është teorike përkundër deklarinimeve periodike vjetore të subjekteve që duhet të jenë konkrete, të detajuara dhe të bazuara në gjendjen reale. Kjo qasje e potencuar nga subjekti në ankim, mbi të gjitha, do të binte ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 e sidomos nenit 4, si dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore në procesin e rivlerësimit për Kolegjin³¹. Për rrjedhojë, pretendimet dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri janë të pambështetura në prova dhe në ligj.

22.8. Në përfundim, lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 84 m², të ndodhur në adresën rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën për blerjen e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

³⁰ Neni 4 i ligjit parashikon: “Subjektet e përcaktuara [...] detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë [...]” – <http://www.ildkpk.al/legjislacioni/>.

³¹ “[...]5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit [...]”.

23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se burimet financiare të përdorura për blerjen e **garazhit me sipërfaqe 22,2 m², me adresë rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, më datë 26.06.2010, në vlerën 14.000 euro, janë të ligjshme dhe vlerësimi i Komisionit për këtë pasuri është i pasaktë; subjekti pretendon se ka provuar që është pronar i ligjshëm i banesës, është paguar tatim në burim për qiranë dhe se qiramarrësi ka pasur burime të ligjshme për pagimin e qirasë paradhënie. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka dhënë shpjegime shteruese dhe të vërteta lidhur me kontratën e qirasë dhe mënyrën e likuidimit, pasi qiramarrësi është paraqitur si menaxher i shoqërisë “{***}” ShPK dhe ka marrë banesën me qira për banim, në funksion të biznesit. Është rënë dakord që pagesa të kryhej paradhënie, në këste. Si rrjedhojë, ai [subjekti] ka marrë vlerën prej 10.800 eurosh, të dorëzuar pjesë - pjesë, të cilat i nevojiteshin për të blerë garazhin. Për caktimin e vlerës së qirasë, është referuar në nenin 22 të ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, për amortizimin. Qiramarrësi ka pasur mundësi financiare për paradhënien pasi ka qenë administrator e pastaj menaxher i shoqërisë “{***}” ShPK, pavarësisht se në kohën e lidhjes së marrëveshjes, administrator ka qenë vëllai i tij. Banesën do ta merrte në funksion të shoqërisë, e cila sipas bilancit të datës 31.12.2009, ka pasur depozitë në bankë dhe llogari të tjera të mjaftueshme për të përballuar paradhënien. Mospasqyrimi i adresës së ushtrimit të aktivitetit në adresën e apartamentit të dhënë me qira është një zgjidhje e qiramarrësit, që duhet të pyetet me cilësinë e dëshmitarit. Mosveprimi i organeve tatimore për pagesën e kryer të tatimit për të gjithë vlerën e qirasë, më datë 28.09.2012, nuk varet nga palët kontraktuese. Analiza e provave nga Komisioni është e njëanshme dhe joreale, pasi referimi në nenin 22 të ligjit nr. 8438/1998 bëhet nga ekspertët kontabël kur llogarisin amortizimin e banesave dhe pajisjeve, ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 03.06.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” (në vijim “VKM nr. 496/2015”), referuar nga Komisioni, ka dalë pas përfundimit të kontratës së qirasë. Restaurimi i apartamentit dhe blerja e pajisjeve janë bërë në vitet 2000 – 2003. Këto shpenzime nuk janë deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë pasi nuk e kanë kaluar vlerën 2.500 euro. Ndërkohë që shpenzimet janë përballuar nga të ardhurat familjare për periudhën 2000 – 2003, të cilat kanë qenë ndër më të lartat në atë periudhë krahasuar me familjet e tjera për zonën. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave për të cilat janë përmbushur detyrimet tatimore, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 01.03.2021, pasqyron pjesë arsyetuese nga vendimi i Kolegjit nr. 12/2018 (JR) dhe kërkon çeljen e hetimit gjyqësor me qëllim rivlerësimin e provave, të cilat janë pjesë e dosjes, dhe administrimin provave të paraqitura në Kolegj, si dhe nëse është nevoja, të pyetet në cilësinë e dëshmitarit qiramarrësi K. K..**

23.1. Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar: (i) deklaram të remë dhe mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen, pasi ndërsa kjo e fundit ka ndodhur në datën 26.6.2010, kontrata e qirasë e cila ka gjeneruar të ardhurat prej 10.800 eurosh është lidhur tre muaj më pas – në datën 30.9.2010; (ii) është e dyshimtë vlera e qiradhënies 300 euro/muaj për apartamentin me sip. 59 m² në Bajram Curri; (iii) pretendimi se është parapaguar vlera totale 10.800 euro (për 3 vjet); si dhe (iv) mënyra e marrjes së kësaj vlere në rrugë jobankare. Pas hetimit administrativ,

Komisioni vendosi të mos i marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja në shumën prej 10.800 eurosh për blerjen e kësaj pasurie, pasi ka vlerësuar se kontrata ka qenë fiktive.

23.2. Nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

- i) më datë 26.06.2020, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së pasurisë garazh [nr. {***} rep., nr. {***} kol.,] me sipërfaqe 22,2 m², në vlerën 14.000 euro. Sipas kontratës, çmimi është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale dhe shitësi deklaroi se i ka marrë në dorëzim të hollat;
- ii) në përgjigjen që shoqëria “{***}” ShPK i ka përcjellë Komisionit³², ndër të tjera, ka bashkëlidhur kopje të mandatarkëtimeve (nr. {***}, datë 01.03.2010 dhe nr. {***}, datë 01.05.2010), si dhe ka konfirmuar se pagesa është kryer në dy periudha të ndara: më datë 01.03.2010 në vlerën 8.000 euro dhe më datë 01.05.2010 në vlerën 6.000 euro;
- iii) të njëjtën përgjigje jep edhe subjekti i rivlerësimit në pyetësin e datës 25.03.2019 (pyetja nr. 3);
- iv) në deklaratën e interesave private për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie me të ardhurat nga *qiradhënia e apartamentit* në Bajram Curri dhe *cash-i* i deklaruar për vitet 2007 – 2008 – 2009, pakësuar në vlerën 1.500.000 lekë;
- v) në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri të ardhurat e kontratës së qirasë së datës 30.09.2010 dhe kursimet familjare;
- vi) kontrata e qirasë [nr. {***} rep., datë 30.09.2010] për apartamentin në Bajram Curri me sipërfaqe 59 m², me qiramarrësin K. K., është lidhur më datë 30.09.2010. Kontrata është lidhur për 3 (tre) vjet, 01.02.2010 – 31.01.2013. Sipas kontratës, ambienti do të përdoret për banesë, qiraja mujore do të jetë 300 euro në muaj, parapaguar nga qiramarrësi për të gjithë periudhën respektive. Në kontratë citohet se qiradhënësi do të paguajë të gjitha detyrimet ndaj shtetit, përfshirë edhe detyrimet tatimore;
- vii) referuar shpjegimeve të dhëna ILDKPKI-së më datë 15.10.2012, subjekti i rivlerësimit sqaron se vlera e aseteve për vitin 2010 është në shumën 3.022.630 lekë, nga të cilat: blerje makine 5.000 euro, blerje garazhi 14.000 euro dhe shlyerje kredie 440.000 lekë. Burimi i aseteve janë të ardhurat e vitit në shumën 3.478.716 lekë, të krijuara nga paga 1.780.000 lekë, nga qiraja 10.800 euro (e marrë në muajin maj) dhe nga pakësimi i *cash-it* të mbartur rreth 200.000 lekë. Po këtu, sipas subjektit, për garazhin e prenotuar në maj 2010 është paguar vetëm vlera 10.800 euro, ndërsa vlera e mbetur prej 3.200 eurosh është shlyer në mars 2011;
- viii) në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më datë 21.01.2015, referuar kopjes së procesverbalit të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësit të datës 02.05.2019 (pyetjeve nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5), subjekti është shprehur se të ardhurat nga qiraja i ka marrë *cash*; z. K. K. menaxhon aktivitetet e vëllait dhe e ka marrë shtëpinë me qira pasi kryesisht e ka zhvilluar aktivitetin në Kosovë;
- ix) në përgjigje të pyetësit të datës 25.03.2019, subjekti i rivlerësimit është shprehur se kur është bërë marrëveshja, qiramarrësi është prezantuar si menaxher i shoqërisë “{***}” ShPK dhe

³² Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.03.2019.

ka marrë banesën pasi kishte qëllim të ushtronte aktivitet biznesi në atë zonë dhe se vlera 10.800 euro e qirasë i është dorëzuar pjesë-pjesë “me sa mban mend” dhe se qiramarrësi ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e paradhënies;

x) në përgjigjen e QKB-së dërguar Komisionit në datën 09.04.2019, nga ekstrakti historik rezulton se subjekti “{***}” ShPK është regjistruar më datë 16.10.2001 dhe prej datës 15.03.2015 ka statusin i pezulluar përkohësisht;

xi) Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka informuar më datë 25.04.2019, se subjekti “{***}” ShPK për vitet 2008 – 2009, ka deklaruar fitimin pas tatimit në vlerat respektive sipas viteve 5.291.894 lekë dhe 2.371.036 lekë; prej datës 24.03.2015 është me status pasiv;

xii) Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka informuar Komisionin [me shkresat e datave 27.02.2019, 28.02.2019 dhe 26.11.2018] se subjekti i rivlerësimit ka paguar tatim mbi qiranë në vlerën 148.379,4 lekë për vlerë principali qiraje 1.483.794 lekë, në datën 28.09.2012 dhe ka kryer deklarime individuale për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017;

xiii) OSHEE, me shkresën e datës 03.04.2019, informon se për abonentin Idriz Mulkurti është hapur kontrata më datë 31.10.2008; bashkëngjitur është përcjellë një kopje e ekstraktit të faturimit për periudhën nëntor 2008 – mars 2019;

xiv) UKT Tropojë informon më datë 28.03.2019, se asnjë prej pjesëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontratë me këtë institucion;

23.3. Për sa më sipër, subjekti pretendon se ka përfituar të ardhura në vlerën e 10.800 eurove që nga muaji shkurt 2010, nga një kontratë e cila u lidh vetëm në shtator 2010. Kontrata është lidhur 8 (tetë) muaj pasi prona ishte dhënë me qira, dhe 4 muaj pasi ishte kryer pagesa e tri viteve, e shlyer e gjitha *cash në muajin maj* (sipas subjektit). Po ashtu, në fashikull nuk ka asnjë gjurmë dokumentare të pagesës nga qiramarrësi të shumës së qirasë, një vlerë e konsiderueshme. Subjekti pretendon që z. K. ka shlyer detyrimin e tre vjetëve në krye të marrëdhënies së qirasë, pa asnjë konfirmim shkresor të transaksionit të deklaruar. Ndërkohë, tatimi për këtë të ardhur është paguar 28 muaj pasi është përfituar shuma [më datë 28.09.2012] nga subjekti dhe përreth 17 ditë përpara se subjekti të nënshkruante procesverbalin dhe dokumentet mbështetëse mbi pasuritë e paluajtshme të deklaruara deri në ato momente, përfshirë edhe kontratën e qirasë, në ILDKPKI, më datë 15.10.2012, në funksion të kontrollit të ushtruar atë vit. Përpos kësaj kronologjie, palët në kontratë heshtin lidhur me përmbushjen e një prej detyrimeve kryesore të saj, sikurse është pagesa. Kjo e fundit nuk gjen pasqyrim as për sa i përket kohës dhe as mënyrës në të cilën do të kryhej, megjithëse palët mund ta kishin detajuar këtë moment të rëndësishëm, të shoqëruar me një shumë të konsiderueshme prej 10.800 eurosh (ose 1.499.148 lekë), të kryer përpara nënshkrimit të kontratës, çka u jepte mundësi palëve që ta detajonin këtë moment të rëndësishëm të marrëdhënies së tyre kontraktuale.

23.4. Më tej, në kushtet kur z. K. ka vepruar në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar³³, detyrimi për tatimin

³³ Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

mbi qiranë do të duhej të përmbushej nga qiramarrësi, çka do të konfirmonte dhe krijonte bindjen e plotë për vërtetësinë e pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi cilësinë me të cilën u paraqit qiramarrësi në këtë marrëdhënie kontraktuale dhe qëllimin e kësaj marrëdhënieje.

23.5. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pakuptimta argumentet e subjektit të rivlerësimit që mbështeten te përfshirja në vlerën e qirasë të “humbjes/dëmit” që qiradhënësi pëson për shkak të amortizimit të banesës dhe pajisjeve/mobilieve të apartamentit, e përlllogaritur në përqindje referuar nenit 22 të ligjit nr. 8438/1998, të ndryshuar. Ky argument i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me parashikimet e Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë. Konkretisht, nga leximi së bashku i neneve 813 dhe 814, paragrafi i parë dhe paragrafi i tretë rezultojnë se ndërsa qiramarrësi përgjigjet për humbjen dhe dëmtimin e sendit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë, por jo kur kjo ka ndodhur si pasojë e vjetërimit. Për rrjedhojë, edhe përfshirja në vlerën e qirasë të mbulimit të shpenzimeve mbi dëmtimet apo humbjet përpara se apartamenti të përdoret nuk është bindës. Përpos kësaj, termi i amortizimit, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438/1998, gjen zbatim në fushën e kontabilitetit të përdorur në përcaktimin e standardeve të kontabilitetit, lidhur me trajtimin kontabël për aktivet afatgjata materiale³⁴. Duke qenë se për procesin e rivlerësimit ka rëndësi të provuarit bindshëm i përfitimt të shumës 10.800 euro në maj 2010 në funksion të ekzistencës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë garazh, ndërkohë që kjo vlerë e përfituar në kohën në fjalë nuk konfirmohet as në kontratën e qirasë, e as me mandate apo transaksione bankare. Si rrjedhojë, ligjshmëria e burimit të kësaj të ardhure mbetet e paprovuar bindshëm. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, përveç bilanceve të shoqërisë për vitet 2008 dhe 2009, nuk paraqiti asnjë dokument që të provojë kryerjen e ndonjë transaksioni të mundshëm financiar nga shoqëria me shuma të ngjashme ose të përfaqësuara me këtë vlerë në kohën e kryerjes së pagesës së qirasë, që mund të ishin indicie për të vërtetuar pretendimet e tij.

23.6. Duke abstraguar nga papërshtatshmëria e referimit në VKM-në nr. 496/2015, në qasje prapavepruese nga ana e Komisionit, në vlerësimin tërësor dhe përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se palët në kontratë, në vitin 2010 kanë përcaktuar qira në shumën 300 euro (afërsisht 41.000 lekë³⁵) në muaj, për një apartament vlere të cilit, sipas EKB-së³⁶, ka qenë rreth 1.610.700 lekë [27.300 lekë x 59 m²], apo sipas pretendimeve të subjektit, 20.000 euro (afërsisht 2.750.000 lekë³⁷). Nga analiza e fakteve të analizuara në tërësi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata e qirasë përmban elemente fiktiviteti. Ky vlerësim bazohet ndër të tjera në elementet që vijnë: a) mospërputhjet mes kontratës dhe pretendimeve të subjektit për sa i

³⁴ <https://amf.gov.al/pdf/ligje/RregulloreNr146,date24072019.pdf> – faqe 3.

<http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SKK/SKK%2005%20Aktivet%20afatgjata%20materiale%20dhe%20aktivet%20afatgjata%20jomateriale.pdf> – faqe 4.

³⁵ Sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

³⁶ https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_2010.pdf - udhëzimi nr. 3, datë 03.02.2010, “Për miratimin e koston mesatare të ndërimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, sipas të cilit çmimi mesatar i shitjes për këtë vit, për qytetin e Tropojës ka qenë 27.300 lekë/m² (rreth 0,110 lekë/m² më shumë krahasuar me vitin 2014).

³⁷ Sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010.

përket qiramarrësit – z. K. nuk është paraqitur në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK, por si individ; b) mungesë dokumentacioni që provon pretendimin e subjektit për biznesin e qiramarrësit në Kosovë, që e bënte banimin në Bajram Curri të domosdoshëm për qëllime biznesi – nga të dhënat e TIMS-it rezultojnë vetëm dy hyrje të z. K. nga Kosova në vitin 2011³⁸ për gjithë periudhën 2010 – 2013; c) fakti që shoqëria “{***}” ShPK nuk rezulton të ushtrojë aktivitet edhe në Bajram Curri; ç) konsumi i ulët i energjisë elektrike³⁹ që tregon që apartamenti për të cilin paguhet qiraja nuk rezulton i përdorur rregullisht; dhe d) kronologjia e veprimeve të kryera për marrjen e qirasë, të shtjelluara në detaj më sipër.

23.7. Për sa më sipër, rezulton që palët kanë nënshkruar një kontratë, e cila ndryshe nga qëllimi për të cilin është hartuar – përdorimi i banesës kundrejt një fitimi për një periudhë kohore të përcaktuar – ka pasur për qëllim justifikimin e posedimit të shumës prej 10.800 eurosh, të përdorur për të kryer një pjesë të pagesës së çmimit të garazhit. Përpos kësaj, ka rezultuar se subjekti, pasi e ka përfituar dhe e ka përdorur këtë shumë, ka kryer pagesën e tatimit pas 28 muajsh, teksa i nënshtrohej kontrollit nga ILDKPKI-ja. Edhe veprimet e subjektit të rivlerësimit duket se konfirmojnë që të paktën në disa elemente, kjo kontratë nuk kishte pritshmëri të ndiqte procedurën normale të një kontrate mes një individi [subjekti] dhe një personi të autorizuar të një personi juridik. Nga ana tjetër, çështja e pagesës së çmimit të blerjes së garazhit shfaq paqartësi në vetvete pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklarime. Konkretisht, ndërsa nga njëra anë ai deklaron se të gjithë pagesën prej 14.000 eurosh e ka kryer në vitin 2010 – sipas mandatarëtimeve të shoqërisë “{***}” ShPK, në *mars 2010* subjekti ka paguar vlerën 8.000 euro dhe në *maj 2010* ka paguar vlerën 6.000 euro – në shpjegimet e dhëna për ILDKPKI-në, në shtator 2012, subjekti ka deklaruar se ka paguar në *maj 2010* vlerën 10.800 euro (vlerën e qirasë), ndërsa në mars 2011 ka paguar diferencën në vlerën 3.200 euro.

23.8. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se kontrata është fiktive dhe, për pasojë, burimi i deklaruar për krijimin e shumës prej 10.800 eurosh që ka shërbyer për financimin e pasurisë garazh vlerësohet si i paligjshëm. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për administrimin e provave të paraqitura prej tij në Kolegj, të listuara në paragrafët 10, pika ix dhe 12, pika ix, dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. K. K. (paragrafi 13, pika ii) është trajtuar në paragrafin 17.1 të këtij vendimi.

23.9. Duke abstraguuar nga problemet që paraqet kontrata e qirasë dhe, për pasojë, edhe shuma që pretendohet të jetë fituar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për të krijuar pasurinë garazh edhe për pjesën që sipas deklaratës së interesave private për vitin 2010, ka qenë nga kursimet *cash* të deklaruara për vitet 2007, 2008 dhe 2009 – përkatësisht 500.000 lekë për secilin vit, në total 1.500.000 lekë në fund të vitit 2009. Nga analiza financiare e kryer në Komision dhe në Kolegj për këto vite, rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për të krijuar kursimet e deklaruara. Në konsideratë të

³⁸ Sipas të dhënave nga sistemi TIMS, i administruar nga Komisioni.

³⁹ Sipas të dhënave të OSHEE-së, për periudhën 01.02.2010 – 31.01.2013.

parimit të mospërkeqësimit të situatës së subjektit si rrjedhojë e ankimit, megjithëse diferenca negative për këto vite thellohet në analizën e kryer në Kolegj, subjekti rezulton me diferencë negative për të kryer shpenzimet dhe kursimet e deklaruara minimalisht në vlerën e përreth (-) 431.142 lekë⁴⁰, për këto tri vite të përlllogaritura në Komision. Për më tepër, duke marrë në konsideratë të ardhurat e shpenzimet familjare të subjektit për muajt janar dhe shkurt 2010 dhe shpenzimet për krijime pasurie – shih paragrafët 24 e në vijim lidhur me automjetin e markës MB – rezulton se subjekti e ka të pamundur të ketë kursyer për këta dy muaj diferencën prej rreth 680.000 lekësh (diferenca mes totalit të pagesave për blerje pasurie deri më 01.03.2010 – në vlerën 2.180.000 lekë, me kursimet e pretenduara se janë akumuluar deri më 31.12.2009 – prej 1.500.000 lekësh).

23.10. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në lidhje me pasurinë e paluajtshme garazh me sipërfaqe 22,2 m², të ndodhur në adresën rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën për blerjen e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 24.** Lidhur me pasurinë *automjet [Mercedes Benz] të blerë në janar 2010*, subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet për blerjen dhe zhdoganimin – përkatësisht në vlerën 5.000 euro dhe 379.054 lekë – janë përballuar nga kursimet e viteve 2007–2009. Sipas subjektit, meqenëse nga analiza financiare rezulton mundësi teorike financiare për të kursyer për këto vite në vlerën 1.074.859 lekë, blerja dhe zhdoganimi i automjetit është mbuluar nga këto kursime dhe, për rrjedhojë, deklarimi në deklaratën *vetting* është i saktë. Subjekti i rivlerësimit e cilëson si të pavërtetë konstatimin e Komisionit në paragrafin 67 të vendimit, sipas të cilit ai nuk ka dhënë shpjegime lidhur me situatën financiare negative për blerjen e automjetit. Shpjegimet e tij janë pasqyruar në pikën 4 të rezultateve të hetimit, ku subjekti u është referuar kursimeve familjare të viteve 2007, 2008 dhe 2009. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor dhe rivlerësimin e provave të paraqitura prej tij, që janë pjesë e dosjes, të administruara nga Komisioni.

24.1. Nga analiza financiare e Komisionit, rezultoi se aftësia reale e subjektit të rivlerësimit për të kursyer ka qenë 595.773 lekë dhe vlera e blerjes së automjetit, përfshirë edhe shpenzimet për zhdoganim, ka qenë 1.073.104 lekë. Sipas Komisionit, subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me këtë situatë financiare negative⁴¹. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej (-) 477.331 lekësh.

24.2. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë një autoveturë në vlerën 5000 euro nga z. R. Z., me kontratën e shitblerjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 18.01.2010. Kontrata përcakton vetëm që vlera është paguar nga palët, ndërsa të dhënat për formën dhe kohën e

⁴⁰ Nga analiza e kryer në Kolegj, diferenca negative rezulton në (-) 977.593 lekë për vitet 2007-2009, në bilanc të të ardhurave kundrejt shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara për secilin vit.

⁴¹ Paragrafi 67 i vendimit.

likuidimit të çmimit nuk janë pasqyruar. Ky transaksion është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave privatë për vitin 2010 [në vlerën 5000 euro], me burim *pakësimi i gjendjes të deklaruar për vitet 2007 – 2008 – 2009, dhe vlerën 1.500.000 lekë*. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë automjet [*tip benz – 200*], blerë 5.000 euro [pa doganë] me kontratën e datës 18.01.2010, zhdoganuar më datë 26.01.2010. Si burim janë deklaruar kursimet *cash* të familjes; vlera deklarohet 5.000 euro dhe 379.054 lekë zhdoganimi. Në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimin se automjeti është blerë me kursimet e viteve 2007 dhe 2008, ndërsa pagesa e zhdoganimit është mbuluar me kursimet e vitit 2009⁴².

24.3. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, siç shtjellohet edhe më sipër lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve për krijimin e pasurisë garazh (paragrafi 23 e nënparagrafët e tij), subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për krijimin e kursimeve të deklaruara për vitet 2007-2008. Sipas kësaj analize, aftësia reale e subjektit të rivlerësimit për të kursyer ka qenë 0 lekë, pasi shpenzimet dhe kursimet e deklaruara nuk mund të përballoheshin me të ardhurat. Po ashtu, ndërsa bilanci negativ i përlllogaritur nga Komisioni për këtë vit ishte (-) 404.227 lekë, në analizën e Kolegjit, bilanci negativ rezulton më i thelluar. Diferenca mes Kolegjit dhe Komisionit qëndron në shpenzimet e jetesës për vitin 2007. Konkretisht, ndërsa përlllogaritja në Kolegj u krye mbi bazën e standardit *zyrtar* të shpenzimeve të jetesës për *vitin 2007*, Komisioni ka përlllogaritur shpenzime jetese më të favorshme për subjektin, duke iu referuar atyre të vitit pasardhës [2008]⁴³. Në përmbledhje të analizës financiare të kryer në Kolegj për vitet 2007 – 2008, diferenca negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve e kursimeve rezulton më e thellë se vlerat e pasqyruara nga Komisioni⁴⁴. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në pamundësi financiare në vlerën e rezultuar nga Komisioni. Njësoj si për vitet 2007-2008, dhe për vitin 2009, sipas analizës së kryer në Kolegj, subjekti ka rezultuar në mungesë të burimeve të ligjshme për shpenzimet dhe kursimet e deklaruara⁴⁵. Diferenca midis analizës financiare të kryer në Kolegj dhe asaj të kryer në Komision për këtë vit vjen nga mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit. Komisioni nuk ka përfshirë në analizë shpenzime për dy udhëtime të kryera nga subjekti dhe personi i lidhur gjatë vitit 2009, për të cilat subjekti pretendon se janë financuar nga persona të tretë, ndërkohë që ky deklaram nuk gjen mbështetje me dokumentacion provues. Në përmbledhje, për periudhën 2007 – 2009, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, subjekti rezulton me një bilanc negativ mes të ardhurave dhe shpenzimeve e kursimeve të deklaruara, minimalisht në vlerën e rezultuar nga analiza financiare e kryer nga Komisioni

⁴² Shpjegime për pikën 4, faqe 2 e përgjigjeve të rezultateve të hetimit administrativ.

⁴³ Shih tabelën në paragrafin 64 të faqes 10 të vendimit të Komisionit. Sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i ILDKPKI-së, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 për subjektin e rivlerësimit sipas përbërjes familjare do të duhet të ishin përlllogaritur në vlerën **1.179.840 lekë** dhe jo **683.100 lekë**, referuar analizës së kryer në Komision.

⁴⁴ Shih edhe poshtëshënimin nr. 40. Në analizën e kryer për vitin 2008 në Kolegj, diferenca negative përlllogaritjet në vlerën (-) 162.882 lekë, ndërsa në Komision në vlerën (-) 124.681 lekë. Komisioni nuk ka përfshirë në analizë shpenzimet për sigurimin e jetës dhe pronës, të pasqyruara nga dokumentacioni bankar me vlerë totale 38.160 lekë.

⁴⁵ Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi të mbulonte me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në vitin 2009, në vlerën (-) 26.915 lekë.

dhe, për rrjedhojë, në pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar vlerën e blerjes së automjetit në vitin 2010. Në konsideratë të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit minimalisht në vlerën e konstatuar nga Komisioni, prej (-) 477.331 lekësh. Në përmbledhje, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

24.4. Përkundër kërkesave të subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor dhe për rivlerësimin e provave të paraqitura prej tij gjatë hetimit, trupi gjykues vëren se në kushtet kur provat e administruara nga Komisioni iu nënshtruan vlerësimit të Kolegjit, duke konkluduar edhe në rezultatet e pasqyruara në paragrafin e mësipërm, çelja e hetimit çmohet e panevojshme.

- 25.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka deklaruar pasurinë *tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², të ndodhur në fshatin {***} [***], Durrës*, pasi mbi të nuk ka pasur asnjë të drejtë reale. Kjo situatë është provuar nga hetimi i kryer nga Komisioni. Nga përgjigjet e institucioneve, ka rezultuar se nëna e subjektit nuk ka pasur tokë në pronësi apo përdorim në Durrës. Deklarata noteriale lidhur me këtë pasuri, në vitin 2013 është hartuar për t'i paraprirë shuarjes së çdo konflikti të mundshëm në të ardhmen ndërmjet trashëgimtarëve.

25.1. Lidhur me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar fshehje në deklaratën *vetting*, referuar deklaratës noteriale nr. {***}, datë 14.10.2013, e cila është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2013. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit pasi konstatoi se ai ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedim të tij. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në deklaratën *vetting* posedimin e paligjshëm mbi këtë pasuri, ashtu siç edhe e ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013.

25.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjet e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, ka deklaruar *shtesë 1.000 m² tokë arë në {***} [Durrës]*. Sipas deklaratës toka ishte e paregjistruar dhe subjekti, nëpërmjet deklaratës noteriale me trashëgimtarët e tjerë, do të vazhdonte procedurat ligjore për regjistrim. Kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjë formë në deklaratën *vetting*. Në përgjigje të pyetësorit të datës 27.03.2019, subjekti i rivlerësimit shprehet se kjo pronë është zënë nga familja e tij në vitet 1996, 1997, si pasojë e lëvizjeve demografike të asaj periudhe, ku një komunitet nga Tropoja janë vendosur në {***}, Durrës. Subjekti ka shtuar se nuk është pronar, pasi toka:

*[...] nuk është përfutuar në mënyrë ligjore. [...] Ne si trashëgimtarë ligjorë të nënës sonë kemi përpiluar një deklaratë noteriale, në momentin e ndarjes së trashëgimisë së nënës tonë, me qëllim që në të ardhmen të mos ketë konflikte [...]*⁴⁶.

⁴⁶ Subjekti ka dhënë një shpjegim thuajse identik në procesverbalin e ILDKPKI-së më 21.01.2015.

25.3. Me deklaratën noteriale [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 14.10.2013, pesë (5) deklarues, përfshirë subjektin e rivlerësimit, deklarojnë se nga pasuria e lënë nga trashëgimlënësja Xh. M., kanë edhe pasurinë e paluajtshme tokë me sipërfaqe 2000 m² të ndodhur në {***}, fshati {***}, Bashkia {***} – Durrës, e cila nuk është regjistruar në emër të znj. Xh. M. në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRRP”) Durrës. Deklaruesit bien dakord që pasuria të ndahet në dy pjesë takuese të barabarta, prej 1000 m² secili, ndërmjet trashëgimtarëve B. M. dhe Idriz Mulkurti. Nga komunikimet e Komisionit me institucionet që administrojnë të dhëna mbi titujt e pronësisë – Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Njësia Administrative {***} – konstatohet se nëna e subjektit nuk është trajtuar me tokë bujqësore dhe nuk disponohet AMTP në emër të saj. Po kështu edhe nga verifikimi në sistemet digjitale të ZVRPP Durrës dhe ALUIZNI-t nuk ka të dhëna (pasuri të regjistruar ose vetëdeklarim për ndonjë objekt informal) në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

25.4. Nga sa më sipër, rezulton se një nga familjarët e ngushtë të subjektit të rivlerësimit – nëna – dhe më pas vetë ai kanë poseduar dhe posedojnë një sipërfaqe toke të konsiderueshme, për të cilën nuk disponojnë asnjë lloj forme pronësie. Duke abstraguuar nga fakti që posedimi pa titull i një pasurie të paluajtshme, në afërsi të bregdetit, nga një magjistrat karriere që ka gjykuar çështje penale të profilit të lartë, produktet e të cilave ndër të tjera investohen haptazi ose në mënyrë të kamufluar edhe në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme të autorëve të këtyre veprave, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, minimalisht cenojnë besimin te sjellja jashtëgjyqësore e subjektit për të respektuar ligjin, apo edhe besimin te drejtësia në përgjithësi.

25.5. Në dritën e faktit që, sipas përmbajtjes së deklaratës noteriale të datës 14.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka pasur pritshmërinë që ta regjistronte këtë pasuri në emër të tij, mbështetur në detyrimet që parashikon ligji nr. 84/2016 dhe në përcaktimet e pikave 8 dhe 14 të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁴⁷, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte marrëdhënien me këtë send në deklaratën *vetting* duke dhënë edhe shpjegimet përkatëse mbi llojin, burimin dhe statusin e së drejtës që ushtronte ndaj tij. Konkretisht, në rubrikën e deklarimit të pasurisë, për sa i përket *objektit* të deklarimit dhe *mënyrës* së deklarimit, formulari dikton përkatësisht si vijon:

⁴⁷ Pika 8 e udhëzimit “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrje, akt marrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porositje etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP.” – dhe pika 14: “Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve etj., në posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këto marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (pronarit)”.

“[...] Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të pasurisë [...], burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to [...] të cilat ndodhen në pronësi, *posedim* ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit [...]” – dhe:

“Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, [...] pjesën takuese që zotëroni dhe burimin e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”.

25.6. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte saktësisht në deklaratën *vetting* situatën faktike për sa u përket pritshmërive të tij nga kjo pasuri, mbështetur në deklaratën noteriale të vitit 2013. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për pasqyrim të pasaktë të marrëdhënies së tij me këtë pasuri duke kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

26. Lidhur me *llogaritë bankare* dhe *shpenzimet për blerje online*, subjekti i rivlerësimit pretendon se personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të depozituara veçmas apo gjendje *cash*. Përdorimi i kartave Credins Bank nga e bija lidhet me blerje *online* të kryera prej saj dhe shoqeve të saj në vitet 2014-2017. Shpenzimet për blerjet *online* përbëjnë shpenzime familjare dhe nuk duhet të pasqyrohen si shpenzime të veçuara; po kështu, shpenzimet e kryera në vitin 2018 janë kryer për veshje të familjes. Komisioni ka pranuar shpjegimet e tij për mospërfshirjen e shpenzimeve të blerjeve *online* për vitet 2014 - 2017, me përjashtim të vitit 2018. Si pasojë e kësaj përlllogaritjeje, shpenzimet e vitit 2018 rezultuan më të larta, në diferencën në vlerën 78.320 lekë. Në vitin 2018, vajza e subjektit ka tërhequr në Union Financiar Tirana 300 euro (37.200 lekë), të dërguara nga E. L. më datë 17.08.2018, për blerjen *online*. Kjo vlerë, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të zbritet nga shpenzimet për këtë vit, të cilat duhet të mbeten në vlerën 41.120 lekë. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor lidhur me këtë çështje dhe administrimin si provë të shkresës së paraqitur nga ana e tij, të cituar në paragrafin 11, pika vi).

26.1. Siç është shtjelluar edhe më sipër, në paragrafin 19.2 për këtë element, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka pranuar shpjegimet deklarative të subjektit të rivlerësimit dhe ka përlllogaritur shpenzimet për blerjet *online* të kryera nga personi i lidhur sipas pretendimit të subjektit. Konkretisht, megjithëse blerja është kryer nga personi i lidhur, Komisioni ka pranuar deklaratën noteriale të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit nga subjekti për të provuar se blerja ishte veprim i përbashkët i disa individëve. Në këtë kontekst, Komisioni ka pjesëtuar vlerën e blerjeve në mënyrë të barabartë – megjithëse konfermat bankare, duke pasur data ekzakte, lejojnë përlllogaritjen e shpenzimit për kohën kur ka ndodhur konkretisht. Së fundmi, pjesën takuese të personit të lidhur, në vlerën 118.803, Komisioni e ka përlllogaritur si shpenzim jetik

jetese të familjes për vitet 2014-2017, duke i etiketuar si shpenzime të përfshira në anketën e buxhetit të familjes të përgatitur nga INSTAT. Komisioni ka konkluduar se meqenëse në strukturën e shpenzimeve, grupi i konsumit veshmbathje është mesatarisht 5% e shpenzimeve totale vjetore, vlera takuese e shpenzimeve të personit të lidhur brenda kësaj përqindjeje do të konsiderohej shpenzim familjar. Për rrjedhojë, meqenëse pjesa takuese, sipas pretendimeve të deklaratës noteriale, për vitin 2018 ishte përtej 5%, diferenca u përfshi në shpenzimet familjare. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrat e llogarive dhe vlerën e likuiditeteve në llogari bankare për personat e lidhur, në zbatim të detyrimit sipas ligjit nr. 9049/2003.

26.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni, nuk konstatohen të administruara akte apo dokumente të kohës në të cilën janë kryer blerjet *online* nga llogaria e së bijës së subjektit të rivlerësimit, një pjesë e shpenzimeve të të cilave të jenë mbuluar nga shoqet e saj sikurse pretendohet. Siç përmendet më sipër, Komisioni ka administruar një deklaratë noteriale të personit të lidhur – E. M. – dhe katër individëve. Sipas kësaj deklarate, blerjet *online* [me kartën bankare të deklarueses së parë] në vlerën 715.211,88 lekë për periudhën shtator 2014 - korrik 2017 janë shpenzime të cilat u përkasin deklarueseve bashkërisht. Njëra prej tyre, Xh. D., deklaroi se vlera prej 240.000 lekësh janë shpenzimet e saj, ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar nga katër deklarueset e tjera barazimisht. Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje se në vijim të jurisprudencës së Kolegjit, në vendime të marra edhe përpara vendimit objekt ankimi të Komisionit⁴⁸, deklarata noteriale e kryer gjatë rivlerësimit – në pjesën fundore të tij, bashkëlidhur rezultateve të hetimit administrativ – ka vlerë të kufizuar në provueshmërinë e vlerës reale të shpenzimeve të kryera nga e bija, pasi rezultoi si përpjekje për të justifikuar shpenzimet në funksion të barrës së provës⁴⁹. Për rrjedhojë, fakti që vetëm përreth 16% e shpenzimeve të kryera, ka qenë për llogari të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit – siç pretendohet në deklaratën noteriale [vlera 118.803 lekë, përkundër totalit të blerjeve në vlerën

⁴⁸ Shih paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani, dhe paragrafin 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, vendime të marra përpara vendimit objekt ankimi. Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini, paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena.

⁴⁹ Shih paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani, dhe paragrafin 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, vendime të marra përpara vendimit objekt ankimi. Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani, paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Dollapaj, paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Çlirim Shahini, paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi, paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Cena.

715.211 lekë] mbeti në nivel deklarativ. Për këtë pretendim të ngritur për herë të parë pas marrjes së rezultateve të hetimit administrativ, subjekti nuk solli dokumentacion apo prova të kohës kur janë kryer këto shpenzime, pavarësisht se argumentoi se pjesa *takuese* e tyre përbënte “shpenzime familjare”. Njësoj mbeti e paprovuar se pjesa e pranuar e shpenzuar nga personi i lidhur i përkiste gjithë familjes, gjë e cila do të mund të afektonte, duke i ulur shpenzimet e jetesës⁵⁰.

26.3. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni ka kryer analizë financiare për subjektin e rivlerësimit edhe për sa u përket shpenzimeve nga blerjet *online* të kryera pas vitit 2016, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*. Në këtë kontekst, bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, trupi gjykues sjell në vëmendje se subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës *vetting*. Kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për vitet 2017 dhe 2018 kryhet nga ILDKPKI-ja. Analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të deklaratës *vetting* mund të kishte relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Konkretisht, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016 me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni [ose Kolegji] në kushtet kur krijohet dyshimi për deklarim të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën *vetting*. Në rrethanat konkrete, nga analiza e akteve në fashikull dhe përmbajtjes së vendimit, nuk rezulton që Komisioni të jetë gjendur në këto kushte apo në rrethana të tjera të cilat të jenë arsyetuar se justifikojnë analizën financiare për periudhën pas janarit 2017. Komisioni ka konkluduar qartë në të paktën tre paragrafë të vendimit⁵¹, që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash* jashtë sistemit bankar të deklaruara në deklaratën *vetting*. Në vendimin e Komisionit nuk pasqyrohet asnjë arsye që ka bërë të nevojshme kryerjen e analizës financiare për elemente që kronologjikisht i përkasin pasjanarit 2017, siç janë ndër të tjera, shpenzimet për blerjet *online* të personit të lidhur apo shpenzimet për shkollimin jashtë të një tjetër personi të lidhur. Për të njëjtin arsyetim, mbetet e pashpjeguar përse në konkluzionet përfundimtare për kriterin e vlerësimit pasuror, titulluar “rubrikën e vlerësimit të pasurisë”, Komisioni ka bazuar vendimin në “pagesën e studimeve për të birin” kryer në periudhën 2017-2018, teksa mungon referenca te pamjaftueshmëria e *cash-it* të dekluar në deklaratën *vetting* dhe të konstatuar gjatë hetimit administrativ. Meqenëse ky fakt nuk përbën shkak ankimi nga subjekti i rivlerësimit, nuk është bërë pjesë e vendimmarrjes së trupit gjykues të Kolegjit.

26.4. Në kontekst të sa më sipër, sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë të shkresës të Union Financiar Tirana, datë 19.07.2019, lidhur me një transfertë të vitit 2018 në drejtim të vajzës së tij, trupi gjykues sjell në

⁵⁰ Ky lloj shpenzimi, sipas Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF), realizuar nga INSTAT-i për vitet 2014 – 2016, varion në vlerat 4,8% – 5,1% të buxhetit gjithsej.

⁵¹ Shih paragrafët 119, 130 dhe 144, përkatësisht në faqet 19, 20 dhe 26 të vendimit të Komisionit.

vëmendje dy elemente. Së pari, sa është trajtuar edhe në paragrafin 17.1 të këtij vendimi, shkresa përbën një akt për të cilin zbatohen kufizimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Së dyti, transaksioni përbën një dërgesë të kryer rreth 19 muaj pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, çka nuk ndikon dhe nuk afekton rezultatet e analizës për periudhën 2003 – 2016.

26.5. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje/shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se zgjedhja e Komisionit për të mos përfshirë shpenzimet për blerjet *online* në analizën financiare për periudhën 2014-2016 në funksion të vlerësimit të burimeve të ligjshme, përveçse bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit [shih më sipër nënparagrafin 26.2] për vlerën e kufizuar provuese të deklaratave noteriale, është e pabazuar në ligj. Konkretisht, në zbatim të nenit 49, pika 4, Komisioni duhet ta bazonte vendimin “[...] vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”. Për sa subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim mbeti në nivel deklarativ dhe e pamundur të ndryshojë qëndrimin e Komisionit. Për rrjedhojë, edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe kërkesat e tij për këtë çështje janë të pabazuara në prova dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve janë mbuluar nga persona të tretë.

26.6. Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë periodikë, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e llogarive rrjedhëse në banka në emër të personave të lidhur. Për herë të parë, subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* gjendjen e likuiditeteve në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank dhe në bankën SEB në Suedi të vajzës së tij, E. M.. Pretendimi i tij se personat e lidhur nuk kanë pasur likuiditete veçmas bie ndesh haptazi me dokumentacionin bankar. Po ashtu, duke pasur parasysh parashikimet e nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 që të deklaronte likuiditetet në llogari rrjedhëse – detyrim i parashikuar në vitin 2003 dhe që nuk ka ndryshuar ndër vite – rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite përmbajnë pasaktësi. Në kushtet kur gjendjet e likuiditeteve në llogaritë rrjedhëse janë deklaruar pjesërisht në deklaratën *vetting* (nuk është pasqyruar gjendja e likuiditeteve në bankë të bashkëshortes dhe vajzës së tij E. M.), vlera e kësaj pasaktësie u vlerësua nga trupi gjykues se nuk përbën mjaftueshëm peshë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

- 27.** Lidhur me *shpenzimet e udhëtimeve*, subjekti i rivlerësimit pretendon se përlllogaritja e shpenzimeve të udhëtimeve të tij dhe familjes, për periudhën 2009 – 2018, është e njëanshme dhe joreale. Në disa raste, persona të tretë të lidhur me të kanë përballuar shpenzimet e udhëtimit të familjarëve të tij. Subjekti ka kërkuar që të pyeten këta individë në cilësinë e dëshmitarëve për të dhënë shpjegime shteruese. Po ashtu, udhëtimet e personit të lidhur [vajzës] jashtë Shqipërisë për periudhën 2009 – 2014 janë përballuar nga bashkëjetuesi i saj. Ky i fundit ka financuar edhe tri udhëtime të tjera të anëtarëve të tjerë të familjes⁵². Po kështu, në vitin 2009, bashkëjetuesi i ka

⁵² Respektivisht, udhëtimin e djalit të subjektit të rivlerësimit më 29.06.2014 – 10.07.2014, vajzës tjetër [jo bashkëjetueses] më 17.10.2014 – 19.10.2014, si dhe të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit më 07.03.2014 – 09.03.2014 – dhuratë për festën e 8 Marsit.

dhënë vajzës tjetër të subjektit 1.000 euro, të cilat i ka përdorur për udhëtimet jashtë vendit në dhjetor 2010 dhe maj 2011. Për të provuar financimin nga ish-bashkëjetuesi i personit të lidhur, subjekti ka paraqitur dy deklarata noteriale të vitit 2019⁵³, si dhe një vërtetim depozite bankare në emër të këtij individi⁵⁴. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë asnjë prej provave shkresore të pranuar, pa ofruar arsytim. Po kështu, Komisioni i përlogarit shpenzimet për karburant si shpenzime të familjes për rastet kur nga sistemi TIMS është regjistruar vetëm hyrja ose dalja, pavarësisht se është provuar që ai dhe personat e lidhur kanë lëvizur me mjetet e tyre. Shpenzimet e udhëtimit për në Tropojë nuk duhet të llogariten më vete pasi ato janë të përfshira në anketën e buxhetit të familjes, pasi janë brenda limitit për shpenzimet për transport familjar, në të cilat sipas anketës së buxhetit të familjes të publikuar nga INSTAT-i, grupi i konsumit transport është mesatarisht 6,8% e shpenzimeve totale vjetore. Shpenzimet e transportit për në punë janë përballuar nga shteti si trajtim preferencial, provuar me shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda [nr. {***} prot., datë 29.07.2019]. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së hetimit dhe të dokumenteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve të datës 01.03.2021, të cituara në paragrafin 10, pikat v, vi, viii dhe në paragrafin 12, pikat iii, iv dhe v, të këtij vendimi.

27.1. Në vendim, Komisioni ka përlogaritur shpenzime për 123 udhëtime në Tropojë dhe 48 udhëtime jashtë vendit, kur subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e të ardhurave të personave të tretë, të deklaruar si financues të udhëtimeve. Për udhëtimet për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues, Komisioni nuk ka përlogaritur shpenzime udhëtimi. Ndërkohë, Komisioni nuk ka përlogaritur shpenzime udhëtimi drejt Tropojës për rastet kur subjekti deklaroi se ai dhe familjarët e tij kanë udhëtuar si pasagjerë në automjetet e personave të tretë dhe as shpenzime për udhëtimet që sipas subjektit janë financuar nga e bija e subjektit, E. M., në vitin 2015, e cila sipas Komisionit ka pasur burime të mjaftueshme financiare nga shitja e një automjeti në vitin 2014.

27.2. Komisioni rezulton të ketë administruar dy deklarata noteriale të kryera nga znj. E. M. më datë 24.05.2019 dhe z. E. G. më datë 04.06.2019, sipas të cilave shpenzimet e udhëtimeve të kryera së bashku në vitet 2009 – 2015 janë mbuluar nga ky i fundit. Po kështu, prej tij janë mbuluar edhe shpenzimet e udhëtimeve në vitin 2014 kur kanë udhëtuar së bashku me vëllanë dhe motrën e E., dhe një paketë turistike për nënën e E. në vitin 2014. Gjithashtu, z. G. deklaroi se në fundvitin e 2010 i ka dhuruar për Krishtlindje motrës së E. (E. M.) 1.000 euro, si dhe ka mbuluar gjatë periudhës 2009 – 2015 shpenzimet vetjake të saj. Z. G. pretendon se ka pasur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet në sajë të biznesit të tij. Në mbështetje, deklaruesi ka depozituar kontratën e depozitës me afat, pranë International Commercial Bank, datë 02.09.2013, në emër të tij, me shumë të depozituar 2.505.000,00 lekë dhe vërtetimin e Drejtorisë

⁵³ Përkatësisht të datës 04.06.2019 dhe të datës 24.05.2019.

⁵⁴ Lëshuar më datë 25.03.2019, nga International Commercial Bank, lidhur me kontratën e depozitës me afat datë 02.09.2013, cituar në paragrafin 12/iv.

Rajonale të Tatimeve Tiranë të datës 23.05.2019, për sa i përket aktivitetit që ai ushtron. Po kështu, subjekti i rivlerësimit u ka bashkëlidhur rezultateve të hetimit administrativ vërtetimin e datës 24.05.2019, nga Union Financiar Tiranë, për 3 transaksione financiare të kryera në datat 12.06.2014, 24.06.2014 dhe 05.12.2016 me përfituese E. M., në shumat respektive sipas datave me vlerë 200 euro, 300 euro dhe 250 euro.

27.3. Po kështu, në dosje gjenden të administruara një kontratë dhurimi automjeti znj. E. M. nga z. G. që mban datën 26.12.2011 dhe kontrata e shitblerjes së të njëjtit automjet e datës 22.10.2014. Vlera e automjetit e deklaruar në dhurim dhe pasi është shitur – tre vjet më pas – rezulton e njëjtë, 6.000 euro. Të dyja transaksionet janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë për secilin vit [2011 dhe 2014].

27.4. Në përmbledhje të sa është paraqitur më lart, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova për të vërtetuar pretendimet e tij mbi mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve të familjarëve nga persona të tretë, në kohën që këto pagesa apo udhëtime janë kryer. Ky pretendim mbeti deklarativ edhe në dritën e faktit që ndërsa këto përfitime pretendohet të jenë të konsiderueshme dhe shtrirë ndër vite, subjekti i rivlerësimit për herë të parë e parashtrori këtë version të fakteve vetëm gjatë hetimit administrativ..

27.5. Për të vlerësuar pretendimet në ankim, të përsëritura edhe në parashtrimet e datës 01.03.2021, lidhur me shpenzimet e udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij për në Tropojë dhe jashtë vendit, Kolegji kreu analizë financiare. Në analizën e kryer në Kolegji janë grupuar udhëtimet për të cilat konfirmohet pretendimi i subjektit për sa i përket destinacionit brenda Republikës së Shqipërisë [Tropojë] nga verifikimi në sistemin TIMS, për hyrjet dhe daljet nga territori i Shqipërisë nëpërmjet pikave kufitare të Morinës, Qafë Morinit dhe Qafë Prushit dhe përlllogaritja u krye pa shpenzime shtesë. Për rastet e tjera – kur mungon të paktën një hyrje/dalje nga Qafë Morini në datat e deklaruara nga subjekti – është aplikuar metodologjia e Kolegjit për përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit, e trajtuar në vendimin e Kolegjit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019⁵⁵.

27.6. Lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor, administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së hetimit dhe të provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve të datës 01.03.2021, të listuara në paragrafët 10, pikat v – viii dhe 12, pikat iii – v, si dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. E. G. (paragrafi 13, pika iii), trupi gjykues në vijim edhe të qëndrimit të shprehur në paragrafin 17.1 të këtij vendimi, vëren se aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ përmbajnë mjaftueshëm të dhëna për të konkluduar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në prova dhe në ligj dhe se ai ka dështuar të provojë bindshëm se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga familjarët e tij brenda dhe jashtë vendit janë mbuluar nga persona të tretë.

⁵⁵ <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>.

28. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet për *shkollimin* e të birit në Angli, justifikohen me burime të ligjshme financiare pasi ka pasur aftësi të kursejë dhe të derdhë në llogarinë e tij bankare shumë prej 1.410.100 lekësh në datën 18.06.2018. Kursimet në totalin prej 1.500.000 lekësh gjendje *cash* në banesë, deklaruar në deklaratën *vetting*, sipas tij, janë si vijon: në vitin 2012 – 500.000 lekë, në vitin 2013 – 300.000 lekë, në vitin 2014 – 650.000 lekë dhe në vitin 2015 – 50.000 lekë. Në këto përlllogaritje, subjekti i rivlerësimit mbërrin duke përfshirë të ardhurat e krijuara nga qiraja e banesës, reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve, si dhe reduktimin e shpenzimeve për blerjet *online*. Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit kërkon në ankim çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së hetimit, si dhe të marrë si provë të re shkresën e Unionit Financiar Tirana nr. {***}, për të provuar se vajza ka tërhequr 300 euro, të cilat i ka përdorur për blerje *online* në vitin 2018.

28.1. Komisioni ka konstatuar se në datën 18.06.2018, subjekti ka kryer derdhje *cash* në llogarinë e tij bankare në Raiffeisen Bank në vlerën 1.410.000 lekë, që sipas përkrahimit janë kursime për *studimet e djalit jashtë vendit*. Subjekti ka deklaruar gjatë procesit të hetimit administrativ se kjo shumë vjen si pakësim i gjendjes *cash* në banesë, të deklaruar në deklaratën *vetting* dhe se burimi i tyre janë kursimet familjare të deklaruara ndër vite. Nga analiza financiare për periudhën 2003 – 2016, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*, por vetëm shumë prej 85.485 lekësh. Në përfundim, bazuar në analizën financiare të rishikuar, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka një gjendje financiare negative, të pajustificuar me burime të ligjshme për vitin 2018, në shumë (-) 1.159.630 dhe se nuk justifikon me burime të ligjshme derdhjen në llogarinë e tij bankare shumë 1.410.100 lekë në vitin 2018, shumë e cila është përdorur për pagesën e tarifës për vitin e parë të studimeve të të birit në Londër, Angli, po në të njëjtin vit.

28.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pa dashur të përsërisë qëndrimin e shprehur në paragrafin 26.3 dhe 26.4 më sipër, thekson se analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën kohore 2017-2018 dhe konkluzioni i Komisionit për pamundësinë e mbështetjes me burime të ligjshme të shkollimit të djalit jashtë shtetit, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për të krijuar me burime të ligjshme likuiditetet në formë *cash* të deklaruara jashtë sistemit bankar në deklaratën *vetting*, përbën një kualifikim të dytë të të njëjtave fakte si shkak shkarkimi. Për pasojë, ky konkluzion është i gabuar. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit, i gjendur në kushtet e konstatimit të këtij gabimi në zbatimin e ligjit material nga ana e Komisionit, vlerëson se rikualifikimi i së njëjtës shkelje për më shumë se një herë, rëndon padrejtësisht subjektin e rivlerësimit dhe humb logjikën e vlerësimit të situatës faktike dhe ligjore. Trupi gjykues thekson që ky element nuk mund t'i ngarkohet subjektit të rivlerësimit për atribuimin e masës e cila është materializuar nga Komisioni tashmë, në dritën e konstatimit të mungesës së burimeve të ligjshme për kursimet jashtë sistemit bankar sipas deklaratës *vetting*.

29. Lidhur me *rezultatet e analizës financiare*, subjekti i rivlerësimit pretendon se rezultati i rishikuar nuk është i vërtetë. Sipas kësaj të fundit, Komisioni ka përlogaritur se për vitet 2006 – 2014, subjekti i rivlerësimit ka një gjendje financiare negative në vlerën totale prej -3.121.085 lekësh. Duke llogaritur të ardhurat e krijuara nga qiraja e banesës, si dhe ndryshimet në shpenzimet për udhëtim dhe për ato për blerjet *online*, rezulton se me të ardhurat e ligjshme është arritur të justifikohen të gjitha shpenzimet e kryera nga subjekti dhe familja e tij përgjatë kësaj periudhe. Për transfertat financiare⁵⁶ të kryera për vajzat e tij, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të konsiderojë mosparaqitjen e dokumentacionit për shkaqe të arsyeshme, provuar edhe nga shkresat e lëshuara prej tyre dhe të listuara në paragrafin 10, pikat vi dhe vii të këtij vendimi. Në parashtrimet e datës 01.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar në përmbajtje gjetje të raportit të ekspertit kontabël, duke konkluduar me balanca pozitive. Më tej, subjekti i rivlerësimit kërkon në ankim dhe në parashtrimet e datës 01.03.2021, çeljen e hetimit gjyqësor, administrimin e provave që janë pjesë e dosjes dhe të provave të reja, të listuara në paragrafët 10, pikat iv – viii dhe 12, pikat iii – vii dhe ix të këtij vendimi.

29.1. Siç parashtron edhe subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar një gjendje financiare negative për të për vitet 2006 - 2014 në vlerën totale prej -3.131.085 lekësh, të pajustificuar me burime të ligjshme dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat e ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh të deklaruar në deklaratën *vetting*, deri në datën 31.12.2016, por vetëm shumë 187.121 lekë.

29.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kontrast me pretendimet e mëparshme gjatë procesit të zhvilluar në Komision apo në ankim, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e datës 01.03.2021, në aktin e ekspertimit ka kërkuar pakësimin e mëtejshëm të shpenzimeve të ndryshme me vlerën respektive që zënë këto shpenzime në shportën e shpenzimeve të jetesës, si pjesë e buxhetit familjar. Konkretisht, subjekti kërkon që shpenzimet për arsimin, kujdesin mjekësor, shpenzime të tjera dhe udhëtime, të pakësohen në vlerën respektive që zënë në shpenzimet e jetesës, si pjesë e buxhetit familjar. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se shpenzimet në fjalë lidhen respektivisht me arsimin privat të personit të lidhur, operacion plastik/ndërrhyrje estetike në institucion privat për personin e lidhur, pagesa për pasaportë – e rimbursuar nga puna – dhe udhëtimet jashtë shtetit. Subjekti kërkon që të gjitha këto vlera të zbriten pasi, sipas tij, janë pjesë e shpenzimeve bazike/jetike.

29.3. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit u morën në shqyrtim nga Kolegji dhe në vijim të analizës së kryer⁵⁷, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare

⁵⁶ Konkretisht, për tri transfertat në Union Financiar Tiranë, nëpërmjet të cilave vërtetohet mbulimin e shpenzimeve për periudhat 16.05.2013 – 19.05.2013, 07.07.2013 – 12.07.2013 dhe 02.04.2014 -05.04.2014, si dhe për një transfertë në Ak Invest në vitin 2013 nëpërmjet së cilës vërtetohet mbulimin e shpenzimeve për një pjesë të pagesës së masterit, në vlerën 126.000 lekë.

⁵⁷ Në analizë janë përfshirë: a) vlerat e pasurive të blera – apartamentit dhe garazhit në Tiranë – sipas përcaktimeve në dokumentet ligjore; b) vlerat e kursimeve cash të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në

për të mbuluar me burime të ligjshme kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve në pasuri në vitet 2006-2015. Në kushtet kur analiza financiare e kryer në Kolegj rezultoi me balancë negative më të thelluar se rezultati negativ i analizës financiare të kryer nga Komisioni⁵⁸, në konsideratë të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në nivelin e përlogaritur nga Komisioni, rezultoi e konfirmuar. Lidhur me mundësinë reale të krijimit të kursimeve *cash*, nga analiza e kryer në Kolegj, rezultoi se qëndron konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të kursyer gjendjen *cash* prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se mundësia reale e subjektit të rivlerësimit për të kursyer deri më 31.12.2016, është në vlerën 0 lekë. Në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe investimet në pasuri të luajtshme e të paluajtshme ndër vite dhe nuk ka pasur mundësi të kursejë nga të ardhurat e ligjshme shumë *cash* prej 1.500.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

30. Lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së hetimit, si dhe të provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve të datës 01.03.2021, trupi gjykues në vijim edhe të qëndrimit të shprehur në paragrafin 17.1 të këtij vendimi, vëren se aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ përmbajnë mjaftueshëm të dhëna për të konkluduar se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në prova dhe në ligj dhe se ai ka dështuar të provojë bindshëm se ka pasur të ardhura të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet

*deklaratat periodike vjetore; c) totali i balancave të të gjitha llogarive/depozitave të subjektit ose personave të lidhur, në lekë ose në valutë të ekuivalentuar me kursin e datës 31 dhjetor të çdo viti sipas konfirmimeve bankare; dhe ç) vlera e kredisë bankare pas zbritjes së komisionit të disbursimit. Në zërin e të ardhurave janë përfshirë: a) të ardhurat nga pagat për subjektin, bashkëshorten dhe fëmijët, sipas vërtetimeve shkresore nga institucionet dhe debitimeve në llogaritë bankare të pagave për të cilat provohet pagesa e detyrimeve tatimore. Në zërin shpenzime janë përfshirë: a) shpenzimet e jetesës sipas metodologjisë së përcjellë nga INSTAT-i ILDKPKI-së, sipas numrit të anëtarëve të familjes në secilin vit; b) shpenzimet e qirasë, shkollimit, mobilimit, mjekësore, shpenzimeve doganore apo taksave të automjeteve, pagesës për ZVRPP, e institucione të tjera; c) shpenzimeve të tjera – sipas faturave të administruara në dosje dhe sipas vlerave të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI apo në përgjigjet e pyetësorëve; shpenzimet e udhëtimeve të nxjerra nga sistemi TIMS, janë përlogaritur sipas metodologjisë të përcaktuar në Kolegj [vendimi i Kolegjit nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019]. Shpenzimet për pagesa kësti kredie dhe shpenzimet për veprime me kartat bankare janë ekstraktuar nga lëvizjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit të dërguar nga bankat e nivelit të dytë. Në zërin e ndryshimit të likuiditeteve, janë përfshirë kursimet *cash* në banesë, të pretenduara nga subjekti si shtesa të viteve përkatëse.*

⁵⁸ Rezultati i analizës financiare të Kolegjit është në vlerën negative prej 7.891.911 lekësh, kundrejt (-) 3.121.085 lekësh të përlogaritur nga Komisioni. Diferencat ndërmjet analizave financiare vijnë për shkak të përlogaritjes së ndryshme të shpenzimeve të udhëtimit, shpenzimeve të jetesës (Kolegji ka aplikuar vlerën e shpenzimeve të jetesës sipas INSTAT-it përcjellë ILDKPKI-së ndër vite dhe përlogaritjen sipas shkresave të të ardhurave dhe shpenzimeve. Konsiderimin e atyre të ardhurave dhe shpenzimeve të konfirmuara me dokumentacion provues. Në analizën e kryer në Kolegj, janë përfshirë shpenzimet e dasmës së vajzës në vitin 2014, të udhëtimeve të personave të lidhur dhe të blerjeve online të kryera nga vajza e tij.

2006 – 2014, dhe likuiditetet në formë *cash* të deklaruara, jashtë sistemit bankar, në deklaratën *vetting*. Për sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit për pamundësinë e paraqitjes së vërtetimit të transaksioneve të kryera në Union Financiar Tiranë dhe Ak Invest, për mbulimin e shpenzimeve të vajzave në vitet 2013 – 2014, brenda kornizave të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, edhe duke e konsideruar këtë kërkesë në këndvështrim garantist për situatën e subjektit të rivlerësimit – duke abstraguuar nga problemi esencial i ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave – sjell në vëmendje se gjithsesi këto vlera nuk afektojnë në masë vendimtare rezultatin negativ të analizës financiare të kryer në Kolegji. Po ashtu, pretendimet në parashtrim për reduktim të mëtejshëm të shpenzimeve, sipas analizës financiare të sjellë nga subjekti, nuk u pranuan për shkak se nuk përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 për mundësinë e sjelljes së pretendimeve/provave të reja në ankim. Edhe nëse abstragohet nga ky parim procedural, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpenzimet e arsimimit dhe kujdesit shëndetësor privat në institucione private nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në kushtet kur të dyja këto shërbime në Republikën e Shqipërisë ofrohen me shpenzime modeste nga institucionet publike, i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është përkufizimisht përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përlllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i. Në të njëjtën qasje, është alogjike që të zbriten/mos llogariten shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë shtetit, duke i konsideruar të përfshira ato nëpërmjet shpenzimeve jetike të llogaritura nga INSTAT-i. Shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtushme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për këto arsye, këto pretendime të subjektit u gjetën të pabazuara.

31. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk janë të sakta, por edhe sikur të merren të mirëqena ato bien ndesh me nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk rezulton të ketë deklaruar *dyfishin* e pasurisë së ligjshme. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që pasi të bëjë analizën e provave, të ndryshojë vendimin e Komisionit dhe ta konfirmojë atë në detyrë. Referuar qëllimit të ligjit nr. 84/2016, subjekti parashtron se ka qenë korrekt dhe ka pasur një performancë të admirueshme sepse ka zbatuar me rigorozitet legjislacionin në fuqi dhe ka gjykuar çështje penale të grupeve më të rrezikshme kriminale në Shqipëri, nuk është tërhequr para presioneve dhe ka dhënë drejtësi, duke u konsideruar si një ndër 10 njerëzit më të vlerësuar për vitin 2015, duke pasur besueshmërinë e publikut në një kohë që besimi te drejtësia ka qenë minimal. Lidhur me këtë, subjekti i rivlerësimi në parashtrimet e datës 01.03.2021 ka mbështetur argumentet në arsyetimin e pakicës në vendimin e Kolegjit nr. 11/2020 (JR), datë 03.07.2020 dhe ka bashkëlidhur aktet e listuara në paragrafin nr. 12, pikat i, ii, x – xii të këtij vendimi.

31.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se masa disiplinore e vendosur nga Komisioni bazohet në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 – deklarim i pamjaftueshëm – ndërkohë që deklarimi më

shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të, parashikohet nga nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë kjo që nuk gjendet e artikuluar nga Komisioni në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, kontributi i subjektit të rivlerësimit në sistemin e drejtësisë është një tregues për çështjen e karrierës dhe profesionalizmit të tij dhe që lidhet me kriterin e vlerësimit profesional, për të cilin subjekti i rivlerësimit nga Komisioni është konsideruar i aftë dhe me nivel minimal kualifikues sipas parashikimeve të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë vlerësimi pozitiv për këtë kriter nuk afekton faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë me burime financiare të ligjshme shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara gjatë kohës së rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

32. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet e paraqitura më datë 01.03.2021, shqyrtoi provat dhe aktet e administruara gjatë hetimit nga Komisioni për këtë çështje, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerëson se:

- i) në lidhje me *pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 84 m² dhe pasurinë e paluajtshme garazh me sipërfaqe 22,2 m², të ndodhura në adresën rr. “{***}”, Njësia nr. {***}, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të bindë Kolegjin se ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat për blerjet e këtyre pasurive, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
- ii) në lidhje me *pasurinë e luajtshme automjet tip “Benz-200”, me vlerë 5.000 euro dhe zhdoganimi në vlerën 379.054 lekë*, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
- iii) në lidhje me *analizën financiare të të ardhurave të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet 2006 – 2014, si dhe likuiditetet në formë cash të deklaruara, jashtë sistemit bankar, në deklaratën vetting*, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016;
- iv) në lidhje me *pasurinë e paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 1.000 m², ndodhur në fshatin {***}, {***}, Durrës*, subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për pasqyrim të pasaktë të marrëdhënies të tij me këtë pasuri, duke kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting*, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016;
- v) sa i përket analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën kohore 2017 - 2018 [pas plotësimit të deklaratës *vetting*], në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për të krijuar me burime të ligjshme likuiditetet në formë *cash* të deklaruara, jashtë sistemit bankar, konkluzioni i Komisionit për mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e shkollës së personit të lidhur [djalit] përbën një kualifikim të dytë të të njëjtave fakte si shkak shkarkimi dhe, për pasojë, është i gabuar.

33. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e deklaruara, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 159, datë 14.06.2019, është i drejtë e duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 159, datë 14.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Idriz Mulkurti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.03.2021.

ANËTAR

Sokol ÇOMO
nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA
nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA
nënshkrimi